

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 208, Shkurt 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Presidenti Federal i Gjermanisë dekoron motrat misionare të Dobraçit 2

Presidenti Federal i Gjermanisë, Shkëlqesia e tij, Christian Wulfi, dekoron motra, që janë dhe punojnë në Dobraç. Ambasadori Peter Zingraf, i dorëzoi të premten "Kryqin Federal të Meritës të Klasit të 1-rë" Motrës Maria Christina në Dobraç (Shkodër). Me këtë urdhër Presidenti Federal i Gjermanisë nderon angazhimin e palodhur të infermieres nga Donauwörth (Bavari) dhe drejtueses së manastirit në Veri të Shqipërisë, së bashku me motrën zvicerane Michaela, dy motrat ofrojnë ndihmë mjekësore, kujdesen për të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara. Ato angazhohen gjithashtu në fushën sociale dhe arsimore. Në laudation me rastin e dorëzimit, në prani të kolegëve të tij zviceran, Ambasadorit Adrian Maître, Ambasadori Zingraf u shprehën "Mbështetja për të sëmurët, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit në nevojë është veçanërisht e vlefshme këtu në Veri të Shqipërisë, ku ka një shtrirje të kufizuar të infrastrukturës shtetërore dhe dimër me netë të ftohta dhe reshje dëbore.

Ndalimi i fesë dhe vitet e trazuarave në 1990 e bënë veçanërisht të vështirë ngritjen e strukturave të kishës.



## Atletika shqiptare në zi Ndahet nga jeta në moshën 77 vjeçare ish kampioni dhe rekordmeni shkodran, Llesh Vuksani 12

Shkodrës, por edhe Shqipërisë po i largohen pak nga pak yjet e sportit, ato që në vite dhe dekada kanë qenë protagonistë në garat kombëtare, dhe po ashtu edhe ndërkombëtare. Njëri prej tyre që u nda këto ditë nga jeta, në moshën 77 vjeçare është ish kampioni dhe rekordmeni i famshëm i atletikës shkodrane dhe asaj shqiptare, Llesh Vuksani. Falë fizikut të tij të përsosur, shtatlartë dhe shumë i fuqishëm, Llesh Vuksani në rininë e tij që spikaste ndër djemtë simpatikë të qytetit verior dhe më gjere, aplikonte me shumë sukses sporte të ndryshme. Por, nisur nga të dhënat e tij fizike, atletika ishte ajo që kërkoi dhe preferoi ta bënte të vetin. Kështu që, trajnerët, ...

## HISTORIA E LEZHËS NDËR SHEKUJ 14

(Vijon nga numri i kaluar)

Lezha mbas pushtimit romak të Ilirisë së Jugut, me 168 para Krishtit, Lezha përmendet si "Municip". Ajo e ruan rëndësinë si qendër ushtarako-administrative dhe si baze detare për Adriatikon verior. Në periudhën romake pati disa rindërtime të rëndësishme të qytetit ilir. Sidomos në Akropol, në hapësirën e qytetit kodrinor, në qytetin e poshtëm dhe në portin lumor.

## ME RASTIN E FESTËS SË KARNAVALEVE ZEF GJETA, ORGANIZOI KARNAVALET E PARA 8

Ishte viti 1296. Në Venecia, festa u bë ligj. Senati i Republikës së Serenissimas deklaroi ditë festive atë që i paraprin Kreshmës (sipas liturgjisë katolike, periudha e pendesës prej 40 ditësh në prag të Pashkëve, nga e mërkura e Përhimët deri të Shtunën e Shenjtë), duke formalizuar atë që tashmë është një traditë ...

## DJEGIA E SHOSHIT DHE SELISË KISHTARE ME 7 SHKURT 1761 10

"Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit", është njëri nga dhjetë kapitujt e librit "Kontribute për historinë Kishtare të Shqipërisë së Epërme të shekullit XVII-XIX, të historianit arbëresh Italo Sarro. Studimi i tij është një përmbledhje koncize e Relacioneve në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan. Libri meriton një analizë analitike në kontekstin historik të një periudhe dy shekullore dramatike, gjakësore, me grabitje shtazore, por edhe të qëndresës drakoniane për ruajtjen lirisë dhe besimit nga agresioni frontal konvertues me shpatë dhe uratë. Autori flet pak e saktë me gjuhën e dokumenteve burimore, të cilat duhet pranuar se janë disi të thata e skematike, më tepër të karakterit fetare se sa të natyrave historike ...

# Presidenti Federal i Gjermanisë dekoron motrat misionare të Dobraçit

Presidenti Federal i Gjermanisë, Shkëlqesia e tij, Christian Wulfi, dekoron motra, që janë dhe punojnë në Dobraç. Ambasadori Peter Zingraf, i dorëzoi të premten “Kryqin Federal të Meritës të Klasit të 1-rë” Motrës Maria Christina në Dobraç (Shkodër). Me këtë urdhër Presidenti Federal i Gjermanisë nderon angazhimin e palodhur të infermieres nga Donauwörth (Bavari) dhe drejtueses së manastirit në Veri të Shqipërisë, së bashku me motrën zvicerane Michaela, dy motrat ofrojnë ndihmë mjekësore, kujdesen për të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara. Ato angazhohen gjithashtu në fushën sociale dhe arsimore. Në laudation me rastin e dorëzimit, në prani të kolegëve të tij zviceran, Ambasadorit Adrian Maître, Ambasadori Zingraf u shpreh: “Mbështetja për të sëmurët, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit në nevojë është veçanërisht e vlefshme këtu në Veri të Shqipërisë, ku ka një shtrirje të kufizuar të infrastrukturës shtetërore dhe dimër me netë të ftohta dhe reshje dëbore.

Ndalimi i fesë dhe vitet e trazuara në 1990 e bënë veçanërisht të vështirë ngritjen e strukturave të kishës. Për këtë arsye ndërtimi i një shtëpie si e juaja ishte dhe mbetet dyfish e dobishme. Nevoja për infermierë në Shqipëri është e madhe. Emigrimi dhe plakja e shoqërisë paraqesin sfida të mëdha për strukturat shtetërore - iniciativa vullnetare si struktura juaj marrin përsipër në këtë kontekst një detyrë jashtëzakonisht të rëndësishme”.

Këto motra misionare të vendosura në periferi të Shkodrës, në Dobraç, filluan ndërtimin e kuventit të tyre. Ngritja e qendrës në një territor të sapo populluar



Në krahun e djathtë janë dy motrat misionare, motër Maria Christina e Michaela ndërsa përball, në të majtë janë Ambasadori Gjerman Peter Zingraf dhe ambasadori Aderian Maitre

me banore të ardhur nga zonat malore, ku mungonte infrastruktura rrugore, energjia elektrike dhe sistemi i kanalizimeve. Ndihma e këtyre misionareve ishte shumë e madhe, duke filluar në ndihmën e pare me materiale mjekësore. Banoret e ardhur nga zonat malore të Dukagjinit, të Pukës, të Tropojës, të Malësisë së Madhe e të tjera, ndihmat kane qene të shumta në infrastrukture, edukim e të tjera. Një

ndihme të veçante kane dhënë në fushën e mjekësisë, që siguruan medikamente jetësore që nuk gjendeshin në Shqipëri.

Respekt për mbështetjen e Nikoll Pjetrit me vëllezër nga Qelza e Pukës, që ju janë gjendur gjithmonë pranë. Këto misionare një rendësi të veçantë ja kushtojnë familjeve të varfëra dhe njerëzve me probleme shëndetësore. Gjithashtu sot, kjo qendër iu ofron 100 fëmijëve kop-

sht falas nga mosha tre deri në shtate vjeç. Një ndihme të pa kursyer iu japin familjeve me probleme të gjakmarrjes.

Këto motra misionare të Kishës Katolike çdo dite shpëtojnë jete njerëzish. Një vlerësim i merituar nga Presidenti i Republikës Federale të Gjermanisë, por duhet të vlerësohen dhe nga autoritetet shqiptare.


ZEF NIKA

## Rrno për me tregue

“Për çdo gjë ka një kohë nën këtë qiell; një kohë më lind e një kohë më vdek; një kohë me i mbledh e një kohë me i largu gurët; një kohë me u rrëzë e një kohë me u ngrit; një kohë me fitu e një kohë me humb, një kohë më u luftu e një kohë me u paqtu... kjo është koha me u fillua”. Kjo thënie në dukje është biblike po qëndron aktuale në çdo kohe e sidomos në këto kohë që po jetojmë. Ne, këto ditë kur puthjet dhe përfaqimet papritur janë kthyer në armë, dhe, të mos takojë njerëzit e afërm është gjest dashurie, në këto kohë kur duhet të jemi më të fortë se kurrë. më të bashkuar se kurrë, në një kohë kur kuptuam se kufijtë janë thjesht formalitete pasaportash, por jemi të gjithë të lidhur më njëri-tjetrin... e megjithatë përsëri njerëzit priren të zgjohen me qëllim, që në mëngjes për të qene negative, për të ndjekur instinktet me ligjin e xhunglës.

Dihet që statikisht në botën e biznesit në 10 njerëz, 9 prej tyre e përcjellin fjalën e keqe, ndërsa fjalën e mire në 10 njerëz, vetëm 1 prej tyre e thotë fjalën e mirë, por duhet të jemi më pozitive, më shume për njëri-tjetrin, si një shoqëri e emancipuar dhe evropiane. Në vendet që unë kam qene, nuk e kam pare me sfiduese jetesën se në Shqipëri presa i përket marrëdhënieve njerëzore.

E duke u nisur nga kjo jo pa qëllim vendosa edhe titullin “Rrno me tregue”, duke u frymëzuar nga At Zef Pllumi, ku thotë se këtij populli “se historikisht e keqja më e madhe Shqiptareve I ka ardh nga njëri tjetri, se ne kemi mllef, se ne kemi inate me njëri-tjetrin”, edhe titulli i botimeve të tij na vjen si porosi që të jetojmë për të treguar çdo periudhe të historisë sonë, si ato që kane qene të errëta si ato që kanë qene të ndriçuara, i detyrohe-



mi ndërgjegjes sonë për këtë, duke qene se jemi të bindur se, nëse nuk tregojmë të shkuarën jemi të destinuar ta përsërisim atë.

Nuk është e lehtë për një popull që ka kaluar kalavare vuajtjesh, që ka kaluar

sfida të mëdha, që paraqitet çdo dite me sfida ekonomike, social-politike, e po në fund kush nuk i ka këto sfida, kush shtet nuk i ka, cili popull nuk i ka, nuk jemi të vetmit, por të jesh i mirë, të jesh është çështje zgjedhje e zgjedhim vetë. Unë e di që kjo gjë të emanciposh një popull nuk është diçka që zgjidhet më një artikull, është një proces që fillon dhe ka fazat e tij.

Kjo është periudha më perfekte për ta filluar këtë proces, nëse për brezin e dyte ose të trete është më sfiduese, le tua bëjmë ne më të lehtë, më të thjeshtë këtë rrugëtim, ku në fund të ditës të vendosim të jemi njerëz, e të jetojmë si njerëz të një shoqërie të civilizuar.

Le të rrijmë më tregue siç na mëson At Zef Pllumi, me tregues veprat e mira edhe ato që na japin mësimet thelbësore për të rritur një brez të shëndetshëm.

Klodjana Serraj

# FAMILJA NË UDHËKRYQ

## Inate dhe xhelozia që lindin në gjirin familjar

Të dashur lexues do të ju njohim me rivalitetin ndërmjet vëllezërve dhe motrave, inate dhe xhelozia që lindin në gjirin familjar, si krijohen dhe çfarë ndodhë.

Rivaliteti ndërmjet vëllezërve dhe motrave në gjak, është po aq i lashtë sa edhe Kaini me Abelin. Nuk mund të themi se vjen nga urrejtja për vëllain apo motrën, por mund të themi se “Thellë përbrenda, në një mënyrë të mjegullt, e kuptoj dhe e ndjejnë dashurin për njëri-tjetrin, por janë arsye të ndryshme që nuk e lenë këtë dashuri të jetë e dukshme”. Është armiqësia që fshihet kaq shpesh nën sipërfaqen e marrëdhënieve motër e vëlla?

«Çdo familje ka një sasi burimesh, disa emocionale dhe disa materiale. Kur vëlla e motër zihen, zakonisht ata bëjnë garë për këto burime, të cilat përfshijnë gjithçka, që nga dashuria prindërore deri te paratë dhe veshja.

Fusha beteje mund të krijohen edhe në ndarjen e privilegjeve dhe përgjegjësi në familje. Fëmijët e mëdhenj, ndoshta e kanë inate faktin se prej tyre pritet të bëjnë pjesën më të madhe të punëve. Këtu ata i hellin sytë tek vëllezërit dhe motrat më të vegjël. Më të vegjlit nuk duan të urdhërohen me thupër nga vëllai apo motra më e madhe ose bëhen xheloz kur vëllai apo motra më e madhe marrin privilegje që ata vetë i lakmojnë. Kështu në familje ka filluar përçarja. Prindërit në këto raste duhet të jenë të kujdeseshin. Sepse këtu zë fillin një e keqe shumë e madhe që rrezikon të zgjasë tërë jetën.

Inati vjen e shtohet tek të vegjlit kur ata shohin përparime dhe angazhime më të mëdha tek vëllezërit dhe motrat më të mëdhenj. Nga njëherë grindje mes motrave apo vëllezërve mund të vijë thjesht si rezultat i përplasjeve të personalitetit. Kur vendoset që njëri nga fëmijët do të shkojë në një kurs, nga prindërit duhet të shpjegohet fëmijëve të tjerë arsyeja. Ky veprim i del përpara inatit.

Parapëlqimet e prindërve janë akoma një mollë shërri. Nuk ka mundësi që një prind t'i dojë të gjithë fëmijët njëloj, pasi ata janë qenie të ndryshme njerëzore dhe në mënyrë të pashmangshme sjellin reagime të ndryshme tek prindërit.

Nëse ndodh diçka që kërkon një rregullim, bëja të ditur që më parë tjetrit dhe jo ta bësh fakt të kryer dhe madje pa e lajmëruar atë. Mos vallë po zihen sepse të prek gjërat? Një adoleshente ankohej: Motra gjithmonë i përdor gjërat e mia pa

më pyetur!. Mund të thërrasësh prindërit për t'i vënë gjërat në vend, por do të ishte më mirë akoma të uleshe me motrën apo vëllain në një moment të qetë dhe të mos kapeshe pas çikërrimave mbi “të drejtat” personale, por të tregohesh i gatshëm për të ndarë” Përpiqu të pajtohesh me disa rregulla lidhur me gjërat që merren hua, një prej të cilave mund të jetë fakti

gjithnjë më e ëmbël.

Motra merr gjithçka që do-ankohet një djalë. – Kurse kur bëhet fjalë për mua, më harrojnë fare. A të duken të njohura këto fjalë? Vëre pak dy termat “gjithçka” dhe “fare”. A është situata kaq e llahtarshme? Ndoshta jo. Edhe nëse ndodh kështu, a është realiste të pritet trajtim krejt i barabartë për dy individë të ndryshëm? Pady-

Megjithatë, përderisa nuk ke motra e vëllezër për t'i ndarë gjërat me ta, ekziston rreziku që të bëhesh egoist. Mundohu ti ndash gjërat me miqtë dhe të afërmit! Ji i vëmendshëm ndaj nevojave të të tjerëve, duke ofruar ndihmën tënde atje ku është e mundur! Njerëzit nuk do të jenë të pranishëm ndaj kësaj bujarie. Ndoshta kupton se megjithëse je fëmijë i vetëm, nuk je aspak i vetmuar.

Ngjashëm, edhe prindërit e tu mund të ndihen të tërhequr nga vëllai apo motra jote, ndoshta sepse kanë interesa të njëjta, personalitet të ngjashëm apo faktorë të tjerë. Kjo nuk do të thotë se nuk të duan. Nëse ndien zemërim apo xhelozia, përpiqu të kuptosh se zemra jote e papërsosur, të ka vënë për poshtë. Mundohu t'i mposhtësh këto ndjenja. Përderisa nevojat e tua plotësohen, përse të shqetësohesh nëse vëllait apo motrës i kushtohet kujdes i veçantë?

Nganjëherë, kjo mund të duket e vështirë për t'u besuar, veçanërisht kur ta sjellin në majë të hundës. Megjithatë, “Është bukur të kesh motra e vëllezër. «Ke me kë të flasësh dhe me kë ta bësh gjëra interesante. Edhe pse mund të dalësh me shokët, gjithmonë ke motrat dhe vëllezërit. Janë gjithmonë të gatshëm kur do të luash një lojë, të bësh shaka apo të shëtisësh në park.”

Një vajzë thotë: “Ke dikë me të cilin të ndash punët”. Të tjerë akoma i kanë përshkruar vëllezërit dhe motrat e tyre si “këshillues dhe dëgjues të veçantë” dhe persona që “i kuptojnë”.

Më vonë në jetë, do të përjetosh me të tjerët të njëjtat probleme që ke tani me motrën apo vëllain. Xhelozia, të drejtat mbi gjërat që të përkasin, dallimet, pamundësia për të qëndruar vetëm, egoizmi, ndryshimi i personalitetit, këto janë probleme që bëhen pjesë e jetës. Duke mësuar të shkosh mirë me vëllain apo motrën, stërvitesh mirë

në fushën e marrëdhënieve njerëzore. Ai që nuk do vëllain e vet, të cilin e sheh si mund ta dojë të tjerët? Herë pas here, do të ndodhin mosmarrëveshje me vëllain apo motrën. Megjithatë, mund të mësosh të ndash, të komunikosh dhe të bësh kompromise. Çfarë do të fitosh me këto përpjekje? Ka shumë mundësi që të dalësh në përfundimin se në fund të fundit. Vëllai dhe motra janë dhurata të shtrenjta që Zoti ti ka dhënë që ti të jeshë i lumtur.

Roza Pjetri



që para se të merret diçka, gjithmonë më parë të pyetet.

Nëse e sheh të nevojshme, bëj kompromise! Në këtë mënyrë, mund ta shohësh zjarrin të shuhet para se të ndizet. Por ç'mund të themi nëse personaliteti i motrës apo i vëllait në njëfarë mënyre të ngrenervat? Në të vërtetë, nuk ke shumë në dorë për ta ndryshuar. Prandaj mëso të durosh tjetrin në dashuri. Mos i zmadhohabimet dhe të metat e motrës apo vëllait, por zbato dashurinë. Mos ji i pagdhendur dhe i pasjellshëm, por largo zemërimin, ligësinë, sharjen dhe të folurit tënd të jetë

shim që jo! Ndoshta prindërit thjesht po u përgjigjen nevojave të tua individuale dhe temperamentit tënd. Por a nuk është e padrejtë që prindërit të mbajnë me hatër njërin nga fëmijët? Jo, medoemos.

Duke qenë fëmijë i vetëm, tek unë përqendrohej gjithë vëmendja e prindërve. Vërtet, vëmendja e tepërt e kushtuar nga prindërit, mund ta bëjë një fëmijë egocentrik. Por nëse prindërit tregohen të ekuilibruar në këtë gjë, vëmendja prindërore mund të të ndihmojë të piqesh më shpejt dhe të ndihesh i lirshëm në shoqërinë e të rriturve.

# Fjala e gjuhës albanishte-shqipe “be-betim/lidhje bese” në aktet e shkruara të noterëve në Komunën e Shkodrës shek XIV-XV!

(Priftërinjtë katolikë dhe noterët vendas, si mësues “të shkrimit tregëtar” në gjuhën vendase/in vernacula lingua por me lettere/germa latine)

## Betim- Besa, një nga fjalët e fshehura autoktone te Statutet e Shkodrës

Mbi fjalën, koncept – fenomenin e arketipin për, “Besë – Besa”, kanë shkruar autorë të huaj, pastaj edhe vendas. Si më të spikatur, veçojmë vëllezërit Frashëri (shih edhe drama Besa e S. Frashërit), më vonë At Shtjefën e Gjeçovi e gjen me përdorin të gjanë në Kanû, pastaj edhe prof. E. Çabej, etj.

Duke parë edhe afri me gjuhët e fqinjëve, Çabej, referuar Brugmann e Mayer, shihte lidhje konceptuale, me greqishten e vjetër dhe dallonte rreth 38 koncepte bazike ose derivate evolucione të fjalës.

Lidhur me vetë etimologjinë e fjalës, Çabej, pranonte mendimin e Brugmann e Mayer, ku ata e shihnin konceptimin “si lidhje be-betim, dhanie bese, bindje” e afërt me gr. e vjetër πειθω – πείσμα.

Ndërkaq, mendimi i përgjithshëm e pranonte se kjo fjalë ishte në përdorim herët në gjuhën albanishte – shqipe e madje mbase ishte huazuar nga fqinjët, por ndonjë prurje e fjalës konkrete si shembull përdorimi e si vërtetim kronologjik në shek XV-XIV, mungonte e nuk dukej gjëkund. (St. Etim., germa B; albforumi.com ... ; etj)

E kisha shënuar fjalën “besa” dhe i kisha vendosur tek një revistë Studime Historike, edhe një skedë lidhur edhe me interpretimin e saj dhe lidhur edhe me një çështje tjetër e vërejtur akoma edhe ma herët, madje të dy çështjet i kisha diskutuar edhe me vetë prof. Lucia Nadin. Ajo, më nxititi ta shkruaja si një studim – diskutim. Kjo kishte ndodhur, aty nga fund nga viti 2002, kur prof. italiane-veneciane dhe aktualisht edhe “Qytetare Nderi”, albane – shkodrane, ma dhuroi edhe me autograf librin, “Statutet e Shkodrës”.

Nadin e kishte shënuar: “Besare = affermare con lealtà” 269; “Bestimo = bestiam” 274; Në f 157, në rregjistrimin e dialektit venetishte, te Cap. 269, viti 1391, rezultonte se kishte hyrë e përshtatur fjala vendase shkodrane në gjuhën venetishte. Ky zbulim padyshim i përket prof. Luçia Nadin.

(“Statuti di Scutari”, bot. 2002, Fjalori..., f 238; f ; shih edhe fotoskanimet.)

Qëlloi, që skeda mbeti aty “e harruar”, sepse nganjëherë ndodh që, “nuk sheh syni, por sheh mendja”, ose në pritje të dilte ndonjë “më bilbil se unë”, siç shprehëj dikur Marin Barleti.

Përsëri, e kisha hasur fjalën “besa” te O. J. Schmitt, “besare” është shqip nga besa, ë (36v) (“Arbëria Venetike 1392 – 1479”, bot. 2008, f 112)

Nisur, nga rendi i be – betimit, që referon Gjeçovi, mbi gjë bagti, bërra; nisur nga bestytini pagane folklorike mesjetare (M’ke lypë bërrët para se çobanin, m’ke lypë motrën para se mejdanin... se ne t’part një Kanû me bes na ka thân, armt’ me lân e mandej gjânë...), pastaj edhe nga sa referojnë, autorët antikë, si Herodoti,

Arsitoteli etj, mbi “Kopetë e bërrave të diellit”, “Mbi Kopetë Pirrike” etj, ka plotësisht mundësi që fjala e jonë si etimon “bêê”, imiton blegrimat e deleve dhe si kronologji zhytet lashtë!

Një trajtim më të veçantë, i ka bërë fjalës besa edhe S. Frashëri. Ai e barazonte fjalën besa edhe në kuptimin e fesë dhe e theksonte; “shqiptarët kishin zënë të marrin besën e turqve ende pa hyrë Turqia në Shqipëri”. Me idetë e përmendura te manifesti “Shqipëria, ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”, ai kishte shkruar edhe dramën Besa. Kjo dramë trajtonte mardhëniet shqiptaro-turke dhe i mëshonte idesë romantike se, “kur shqiptari jep fjalën Besa, ther djalën”. Ky lloj morali dhe subjektivizmi, bëri që shfaqja e kësaj drame nuk pati sukses dhe u kritikua.

Mund të thuhet pa frikë se, botimi i “Fjalori i Shqipes së sotme”. Bot. 1984, me redaktor Androkli Kostallarin, f 76 – 77, konkretisht lidhur me fjalën “besa e berrejtshëm”, dhe derivatet paraqet një seri mangësish e të metash.

### Një sinjalizim dhe një zbulim i pavumë re i prof. Injac Zamputit, i vitit 1980!

E dinim qysh heret Relacionin e kryepeshkopit të Tivarit, G. Adae të vitit 1332, ku shkruhej: “Dhe sado që ata albanitët kanë një gjuhë tjetër, fare të ndryshme nga ajo latine, megjithatë ata kanë në përdorim si dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën (lettere) latine”.

(“Bur. Të Zgj., për Hist. Shqip., Vell. II. 1962, Dok. 68 dhe 125.)

Nga fisi e familia jonë, kemi patur fatin të kishim edhe një kryepeshkop të Tivarit,

në vitin 1745, Mark de Luka/Lukiqi, Arqipeshkvi i Tivarit 1743 - 1749.

Po ashtu e kemi ditur e kemi shkruar edhe mbi “shkrimin sipas mënyrës tregëtare”, mbi shkollat private në Shkodër, më 1367, më 1388, etj.

(“Bur. Të Zgj., për Hist. Shqip., Vell. II. 1962, Dok. 126,127,128; shih edhe fotoskanimin.)

E natyrisht, në lidhjen me këto, kishim bashkangjitur edhe atë pikën nevralgike, ku çdo shkodrani i shkon mendje - gjuha në nervin e dhambit, “tek fagmente analet e shkruara në gjuhë popullore, simbas referimit të memorieve të të vjetërve tonë”/In his enim vernacula lingua scriptum est: Rosam quendam, cum Pha sorore sua, primos fundadores urbis Scodra fuisse... (Rrethi i Shkodrës, përkth., 1967, f 35)

Nga aktet noteriale të noterëve vendas e atyre vendikas në Komunitat tona te shek XIV, flitej e shkruhej edhe për akte, privilegje, testamente e etj, të hartuara me kohë, simbas lidheve e zakoneve të maparshme e madje edhe antike! Prof. I. Zamputi, në vitin 1980, sapo kishte zbuluar se, noterët vendas, në Ulqin, Shkodër, Drisht etj, simbas “de antiga uzanxa, segundo nostre uxance”, shkruanin Karta dhe njëkohësisht i mësonin bijve të qytetarëve një lloj shkollimi këndim e shkrim.

(ASV, Commem.X/7v, nr.10; X/8, nr.11; shih edhe fotoskanimin)


Kemi arësye të besojmë se, “shkrimi simbas mënyrës tregëtare” ka përfaqësuar një lloj shkrimi të gjuhës vëndase albanishte – epirotishte me germa latine e natyrisht edhe një lloj matematike sado të

thjeshtë për llogaritje.

Kohët e fundit disa kërkime të studiuesit Mark Palnikaj janë mjaft frytdhënëse e shpresdhënëse, po ashtu Bashkia do bante mirë të angazhonte një grup pune kërkimesh arkivore jo vetëm në Itali, por edhe në familiet shkodrane...


Besoje se ja mbajta besën, mikut tim, Z. Ndue Sana, i cili nisur nga një postim i imi në fb, më inkurajoi ta zgjeroja e ta botoja te gazeta Dukagjini.

Agron Luka




Rev. Studime Historike, 1980, 3, fq. 170 – 187, studimi i prof. Injac Zamputi, me Rezyme përkthim frengjisht nga Kolë Luka

Table with two columns of words and their meanings in Latin and Italian. Includes terms like 'bandizare', 'barattero', 'barba', etc.



Statutet..., fq. 157



Bur. të Zgj. për Hist. Shqipërisë, Vell. II, 1962, fq. 195

L. Nadin, “Statutet e Shkodrës”, botim 2002, fq. 238

# PROMOVOHET SHOQATA KULTURORE “XHUBLETA E ALPEVE SHQIPTARE”

E diela e parë e muajit shkurt 2021 shënoi një ditë shumë të veçantë për Bajzën e Kastratit në Malësi të Madhe, ku u promovua Shoqata Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”, një shoqatë e cila që nga emri kuptimplotë nënkupton edhe qëllimin dhe synimet e saj, e cila duke filluar që nga sot mori detyrën e vështirë e fisnike për ta mbrojtur këtë pasuri të paçmueshme e unike në traditën mijëra vjeçare të Kombit tonë.

Nën kujdesin e organizatores, e cila është njëkohësisht edhe themeluesja e kësaj shoqate zj. Rita Shkurtaj në bashkëpunim me stafin, aktivistë të shoqatës, zhvilluan një aktivitet kulturor në një nga vendet më të bukura dhe historike, tek “Shpella e Frashnit” në qendër të Bajzës.

Të ftuar në këtë aktivitet ishin studiues, gazetarë, shkrimtarë, por edhe shumë banorë vendas, të cilët u mahniten nga emocionit që përftuan pasi kishin pritur me kaq kënaqësi këtë ditë të veçantë për gjithë Malësinë. Interesim të madh kishin treguar edhe mediat vizive.

Unë pata kënaqësinë t’i përjetoj këto çaste me mikun tim prof. Osman Kozmaj, i cili ka dhe një kontribut modest në publikimin dhe jehonën e themelimit të kësaj shoqate, e cila ka pretendimin e ligjshëm që këtë simbol të kulturës materiale e shpirtërore të Kombit tonë ta promovojë edhe në UNESCO si pasuri e gjithë njerëzimit.

Kjo nisëm është nga zonja Shkurtaj, që thesaret e çmuara të trevës së Malësisë të ruhen, por edhe të njihen nga Bota, pasi Xhubleta është një veshje tipike e grave në Malësinë e Madhe, ajo është unike dhe me pamje madhështore. Xhubleta identifikon rrënjët tona të hershme ilirjane, dëshmi e qartë se jemi autokton në këto troje.

“Shpella e Frashnit” në Bajzë të Kastratit të Malësisë së Madhe, e njohur ndër shekuj si skena natyrore e kësaj zone ku mbledheshin malësorët në gëzime e festa, jo pa qëllim u zgjodh për të zhvilluar aktivitetin prezantues të Shoqatës Kulturore “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”. Kryetarja e kësaj shoqate Rita Shkurtaj, thotë se ka për qëllim të mbrojtë bukurinë e Xhubletës, e cila ka mbijetuar për më shumë se 4000 vjet në Alpet Shqiptare dhe është unike në Botë.

Kjo shoqatë do t’i kontribuojë edhe vendimit të Ministrisë së Kulturës që “Xhubleta e Alpeve Shqiptare” t’i prezantohet UNESCO për ta shpallur si pasuri në trashëgiminë kulturore botërore.

Një dritë jeshile për Xhubletën e Malësisë.

Kjo iniciativë ka ardhur në kohën dhe momentin e duhur kur vetëm pak kohë më parë Ministria jonë e Kulturës ka anonçuar punën e nisur për



Zonja Rita Shkurtaj, organizatorja e themelimit të kësaj shoqate dhe kryetarja e saj



krijimin e Dosjes përkatëse përmes së cilës do t’i kërkohet UNESCO-s listimin e Xhubletës Shqiptare në Pasuritë Botërore të Trashëgimisë.

Kryetarja e kësaj shoqate zj. Shkurtaj falënderoi me fjalët më të përzemërta gjithë të pranishmit emër për emër, e në veçanti të ardhurit nga larg shumica edhe përfaqësues institucionesh, miqtë nga Tirana, nga Lezha, nga treva e Dukagjinit njëkohësisht përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” me kryetar z. Ndue Sanaj, nga Shkodra dhe nga të gjitha trevat e Malësisë së Madhe.

Një falënderim i veçantë shkon për mediat e pranishme TV1 Channel, me drejtor z. Edmond Ndou dhe gjithë stafin që ishin të pranishëm. Zj. Shkurtaj falënderoi gjithashtu TV Koplikun me drejtor z. Zenel Hoxhaj dhe kryeredaktor z. Gëzim Vuçaj, njëkohësisht edhe drejtor i Revistës “Fjala” për suportin e vazhdueshëm që jep në kuadrin e ringritjes së vlerave sociale e kulturore, si dhe shumë gazetarë e publicistë të pranishëm, të cilët



i dhanë më shumë kuptim këtij aktiviteti modest, por kuptimplot brenda mundësive që lejon situata.

Një falënderim shumë i përzemert shkon edhe për përfaqësuesit dinjitoz të grupit folklorik “JEHONA E KELMENDIT” me drejtuese zj. Dila Vaçaj, të cilët demonstruan ato emocione “Logu”, të cilat prej dekadash i mungonin Grykës së Shpellës së Frashnit.

Gjithashtu një falënderim tjetër shkon edhe për donatorët; z. Fatmir Shpellzaj dhe z. Ramadan Lika, të cilët financuan dhe mundësuan këtë aktivitet.

Ky ishte hapi i parë i rugëtimit tonë të përbashkët ndaj ju ftojme të gjithëve të bëheni bashkudhëtarë të kësaj

nisme kulturore gjithëpërfshirëse. Suksesi na bën krenar dhe optimist për të tjera sfida, tha në fjalën e saj zj. Shkurtaj.

Kjo përshëndetje përmbylli gjithë aktivitetin e prezantimit të shoqatës “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”.

Në Malësinë historike e fantastike, i uroj Shoqatës së drejtuar nga Rita Shkurtaj udhë të mbarë e suksese për nismën e saj, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore! Ishte ky një urim nga z. Sejmen Gjokoli nga Vlora, i cili është i dashuruar me Shkodren dhe shkodranët, por dhe pjesëmarrës në disa veprimtari kulturore e artistike që organizohen në Shkodër.

Urimet më të mira për organizatorët e kësaj veprimtarie, Shoqatës më të re me fokus trashëgiminë kulturore me emrin e bukur, “Xhubleta e Alpeve Shqiptare”.

Ramazan Çeka, Shkurt 2021



Simboli “Shpella e Frashnit!”

# MIRË SE NA ERDHE DOKTOR HALIT KARAXHA!

Republika e Kosovës, Ansambli Folklorik Burimor Mbarëkombëtar, selia Prizren-Kosovë, "KRENAR ME Dr. HALIT KARAXHA, NGA MALISHEVA E KOSOVËS". Mirënjohje dhe respekt për Dr. Halit Karaxha OBSTETER-GJINEKOLOG, që u rikthye përsëri pranë Maternitetit Burrel.

Puna ka filluar me përkushtim të jashtëzakonshëm si në lindjet, operationet cezariene, vizitat gjinekologjike, ECOT, abortet, dhe të gjitha shërbimet në Maternitet.

Doktor, zoti Karaxha i palodhur duke ju shërbyer me shumë korrektësi dhe pse mbingarkesa e punës gjatë këtyre ditëve, është e madhe. Nëna, gra shtatzëna, nga Mati, Klosi, dhe Bulqiza vazhdojnë të vijnë për shqetësimet e tyre në çdo drejtim të shërbimit Obstetrikë Gjinekologjik pranë Maternitetit Burrel, ku zoti Karaxha është treguar i gatshëm në çdo kohë për shërbimin e tyre.

Një mirënjohje e veçantë për të gjithë grupin e maternitetit Burrel, në veçanti për kontribuuesen e veçantë dhe njeriun e palodhur Engjëllushe Gjoka (Qytetare Nderi e Bashkisë Mat), ku me shumë humanizëm shërben me korrektësi ndaj



*Ikli Punavija dhe doktoresha Engjëllushe Gjoka foshnjave të sapolindur, duke qëndruar në çdo kohë dhe kurrë nuk thotë se ndjehem e lodhur.*

Mirënjohja dhe respekti dhe një falënderim i veçantë për Drejtorin e Spitalit Bashkiak Mat, zotin Roland Meta për gjithë mbështetjen e dhënë dhe preokupimin pranë Ministrisë së Shëndetësisë për rinovimin e kontratës së Doktor Halit Karaxha. Pas publikimit të miratimit të kontratës së Dr. Halit Karaxha, Grupi Folklorik "Petralba" Bashkia Klos, i drejtuar nga Ikli Punavija dhe Ansambli Folklorik Burimor Mbarëkombëtar pub-

likoj gëzimin e këtij lajmi pasi doktoreshë Engjëllushe Gjoka, ishte e para për publikimin e saj, me këtë lajm të gëzuar për bashkësinë matjane e më gjerë. Për punën e tij të palodhur dhe korrektësinë e humanizmin ndaj pacientëve nga Mati, Klosi e Bulqiza, Ansambli Folklorik Burimor Mbarëkombëtar mendoj që në Gazetën "Dukagjini" të bëj një shkrim për këto njerëz me vlera, si doktori nga Malisheva e Kosovës zoti Halit Karaxha dhe doktoresha nga Mati i Shqipërisë zonja Engjëllushe Gjoka, që në fushën e mjekësisë japin një kontribut të shquar.

Respekti për mikun tonë zotin Halit Karaxha dhe doktoreshën e Matit, njeriun e palodhur, Engjëllushe Gjoka!

Një falënderim veçantë e kemi dhe për rapsodët nga Malisheva Shaban Bytyqi dhe Nuhi Dobruna, të cilët janë miqtë e ngushtë zotit Ikli Punavija.

Me shumë respekt grupi i Ansambllit, Këshilli Mbarëkombëtar: Jakup Krasniqi – Malishevë, Prof. Mr. Blerim Gashi – Prizren, Ikli Punavija – Mat, Dashnor



*Drejtori spitalit Bashkiak Mat, Roland Meta dhe doktori gjinekologu Halit Karaxha*

Gërmizaj – Prizren, Hajri Ismani – Maqedoni, Ndoc Fusha – Shkodër, Burhan Limani – Bujanoc, Gjon Kosteri – Shkodër, Prelë Milani – Shkodër, Hanife Krasniqi – Diasporë, Sulejman Beqaj - Mali i Zi.

**ANSAMBLI FOLKLORIK BURIMOR MBARËKOMBËTAR, KRYETARI IKLI PUNAVIJA BURREL, MË 03. 02. 2021**

## Letër për dr. Mark Palnikaj

I dashur z. Palnikaj,

Keni falënderime të përzemërta për pakon e librave, që erdhi para pak ditësh këtu. Ju përgëzoj për këtë prodhim të konsiderueshëm për nga vëllimi. Ju jeni një studiues i zellshëm dhe i suksesshëm, ndërsa unë eci gjithmonë e më ngadalë përpara, ndoshta për shkak të moshës.

Shpresoj ta keni marrë veten ndërkohë nga sëmundja e rëndë që kaluat. Ne të gjithë këtu shpresojmë të vaksina e re.

Vëllimi 5 i Albania Sacra (Dioqeza e Shkodrës) ndërkaq është thujse gati, përveç regjistrimit dhe me gjasë do dalë vitin që vjen. Me këtë mbyllet seria. Albania Sacra siç dihet është e ndarë sipas dioqezave dhe trajton vetëm dioqezat që gjenden brenda kufijve të shtetit shqiptar të sotëm, në këtë mënyrë Tivari dhe Shkupi mbeten jashtë.

Nga librat që më dërguat, natyrisht më ka interesuar në mënyrë të veçantë vëllimi me relacionet e vizitave apostolike. Ka dalë shumë mirë në versionin dygjuhësh. Edhe unë e quaj të rëndësishëm relacionin e Stefan Gasparit, ndonëse personi i vizitorit nuk më pëlqen. Ai për secilin nga bashkëvëllezërit e tij klerikë ka diçka për të zbuluar (spiunuar). Për peshkopin Pjetër Bogdani shpif rregullisht (f. 94-97).

Për sa i përket P. Giacinto da Sospellos duket se faktikisht keni bërë një zbulim në Fermo. Por a bëhet fjalë vërtet për një histori të Shqipërisë apo për një raport (relacion) të zgjeruar mbi misionin françeskan në Shqipëri? Nga ato pak kopje mezi të lexueshme kjo nuk dallohet. Nëse do të jetë i për-

shtatshëm për botim (i botueshëm), duhet ta bëni në formën si te Gaspari. Albania Sacra, për arsyet e përmendura më lart, nuk vjen në vështrim.



Po ju bashkëngjisë një punim të vjetër timin, raportin e vizitës së Vincenzo Zmajeviqit të vitit 1703, të cilin e pata botuar para se të filloja me Al-

bania Sacra.

Përsëritje të përzemërta dhe urimet më të mira për vitin e ri, qofshi me shëndet!

P.S. Kopjen e dytë të "Relatione"-s do t'ia jap Bibliotekës shtetërore të Bavarisë

Peter Bartl



# Populizmi dhe politikanët populistë



Populizëm, do të thotë afrim, lidhje me popullin (popullor). Kjo fjalë vjen nga latinishtja, nga fjala populus, që në shqip, do të thotë popull.

Nëse një politikan, është afër popullit, i shkrirë me popullin, gju më gju me popullin, mendohet populist (popullor). Teorikisht, një sjellje e tillë e politikanëve, mendohet gjë pozitive. Të gjendesh në mes të popullit, të shkrihesh me popullin, për të njohur problemet e tij dhe t'i përkushtohesh zgjidhjeve të tyre, nuk ka më mirë.

Në fakt, kjo është detyra e politikanëve.

Nëse ka akoma politikanë të tillë!?

Kjo është çështja.

Meqenëse ka shumë pak të tillë, ose hiç fare, fjala popullsitë, ka marrë një kuptim tjetër, "mashtues".

Thuajse të gjithë politikanët, vazhdimisht por, më së shumti në fushata elektorale, shkojnë tek populli, ulen gju më gju me popullin dhe premtojnë gjëra të cilat nuk mund të realizohen dhe as që mund të bëhen kurrë realitet. Premtojnë utopizma.

Një sjellje e tillë, është aktrim i politikanëve sharlatanë, për të fituar besimin dhe konsideratën e masave. Ky është populizëm.

E dinë ata një gjë të tillë, se po e mashtrojnë popullin?

Po, e dinë shumë mirë dhe e bëjnë me vetëdije të plotë.

Politikanët, në premtimet dhe propagandën e tyre, sidomos gjatë fushatës elektorale, duket se mbështeten në principin e Hitlerit, i cili thoshte:

"Për politikanin, nuk ka rëndësi çfarë thotë, nëse thotë të vërteta apo gënjeshtër. Rëndësi ka që, ato që i thotë, t'i thotë fort, më zë të lartë dhe t'i përsërisë disa herë, derisa njerëzit t'i marrin për të vërteta. Në fund fare, askush nuk është në gjendje të vërtetojë, nëse thotë të vërteta apo gënjeshtër".

Politikanët janë vetëmbrojtur mirë me ligje, nga ligji. Ata nuk mbajnë përgjegjësi për mosrealizimin e premtimeve të tyre, as për mendimin e tyre.

Atyre u intereson "peshkimi" i votave dhe flasin "me gojën e popullit".

Politikani populist, për probleme të veçanta, për ato që janë më të ndjeshme për popullin, premtion shumë zgjidhje. Premtimet e tij, megjithëse janë vetëm utopi, tingëllojnë bukur në veshin e popullit. Turmat entuziazmohen dhe turren pas tij. Zakonisht, turren pas atij që premtion më shumë.

Populistët, e njohin mirë, artin e propagandës trushplarëse. Në fushata elektorale, ata, krahas "kulaçit" premtojnë edhe "kërbaçin". "Kulaçin" për popullin, "kërbaçin" për armiqtë e popullit.

Populistët, me qëllim që të bashkohen sa më shumë njerëz rreth vetes, ia fusin frikën popullit. Sajojnë armiqtë e popullit, "ferri" dhe fillojnë luftën kundër tij. Kjo me qëllim për të marrë përsipër rolin e shpëtimtarit.

Votat, votat, u duhen votat, jo e vërteta.

Populistët ngjallin debate për gjëra fare të parëndësishme, edhe për ato gjëra që nuk ekzistojnë.

Ata përmbysin historinë, identitetin dhe dinjitetin e kombit. Rivrasin të rënë, figurat e shquara të kombit, dhe ringjallin armiqtë, terroristët e popullit. Merren me "llomotitje bizantine". Ata prodhojnë intriga dhe shpifje të pafundme për kundërshtarët e tyre. Nuk iu interesojnë provat, dhe aq më pak, vërtetimi i provave.

Populistët kanë shumë fytyra, por zakonisht grupohen në dy grupime të mëdha: në populistë të djathtë, dhe në popu-

lit dhe nxisin turmat kundër tyre. Nëse është e tillë apo jo, për ata, nuk ka shumë rëndësi.

Zhvillimi i partive populiste të djathta, në Evropë, është fillimi i neofashizmit, është një formë e moderuar e lëvizjeve ekstremiste të djathta.

Në fundin e shek. 20-et, populizmi i djathtë, e mbuloi gjithë Evropën. Filloi në Angli në vitin 1993 me krijimin e partisë "United Kingdom Independence" (UKIP), vazhdoi në Itali me krijimin e partisë "Forza Italia", në vitin 1994 nga mania i medias Silvio Berlusconi. Vazhdoi me zviceranin Christoph Blocher i cili themeloi "Partinë Popullore Zvicerane" (SVP).

Në vitet 2000 vazhdoi lista me partinë holandeze "Partij voor de Vrijheid".

Sot, në Evropë, njihen shumë parti populiste të djathta si: në Austri partia "FPÖ", në Francë partia "Fronti Nacional", në Poloni partia "Prawo i Sprawiedliwosc", në Danimarkë "Dansk Folkeparti", në Holandë partia "Partij voor de Vrijheid", në Belgjikë partia "Vlaams Belang" (ish

Principi bazë i tyre, për qeverisjen e vendit, është funksionimi vertikal i institucioneve shtetërore. Shteti duhet të kontrollohet nga njeriu i plotpushtetshëm. Zakonisht, në krye të këtyre lëvizjeve politike, vihen tipat "revolucionarë", të zjarrit dhe bombave. Principi bazë i tyre, për marrjen e pushtetit është, "nga aksioni tek ideja".

E gjithë "filozofia" e tyre, edhe nëse mendohet humane, është vetëm utopi.

Sot, populistët e majtë, më së shumti, janë të njohur në Amerikën Latine (Argjentinë, Bolivi, Brazil, Kili, Ekuador, Guaiana, Peru, Uruguai, Venezuela), Të tilla parti dhe lëvizje ka edhe në Amerikë, Kanada dhe Evropë. Përfaqësuesit tipikë të tyre janë "të gjelbërit". Në Gjermani njihet Partia Socialiste Gjermane (PDS). Në Itali grupimi politik kundër Berluskonit "Girotondi" (nga 2002-2003), në Çeki partia "Komunistička strana Čech a Moravy" dhe në Slovaki partia "Komunistička strana Slovenska".

Është vetëvrasje masive, nëse njerëzit do të mendojnë dhe besojnë se, populistët,



listë të majtë.

Populistët e djathtë shquhen si nacionalistë. Janë për kulturën nacionale dhe kundër kulturave të huaja. Përzjerjen e kulturës nacionale, me kulturat e tjera, e mendojnë rrezik kombëtar, prandaj janë kundër politikës së pranimit të të huajve. Të ardhurit nga vendet e tjerë, ata i mendojnë rrezik, "ferri i kombit".

Për rritjen e kriminalitetit dhe të papunësisë, ata fajësojnë të huajte e ardhur.

Sipas tyre, "ferri" janë të huajte, brenda dhe jashtë kombit. Mbështetur në këtë princip, ata janë për spastrimin e kombit nga të huajte dhe kundër anëtarësimeve dhe lidhjeve me të tjerët, jashtë kombit.

Brenda nocionit, sipas tyre, "ferri" i vërtetë, mbi të cilin qëllonjë me "zjarr të përqendruar", janë kundërshtarët politikë, drejtësia dhe media.

Ata e epitetojnë kundërshtarin politik "elitë e korruptuar", gjakpirëse e popu-

Wlaams Blok), në Norvegji partia "Fremskrittspartiet", në Itali partia "Lega Nord", në Zvicer partia "SVP", në Gjermani partia "AFD".

Populistët e djathtë, një "qime" i ndanë nga ekstremistët e djathtë, ose aspak. Janë maska e neofashizmit.

Populistët e majtë në princip, janë për një demokraci sociale. Ata theksojnë dhe mbrojnë të drejtat sociale, janë antikapitalistë, antiglobalistë dhe pacifistë. Janë kundër çdo lufte dhe dërgimit të trupave ushtarake. Ndryshej nga socialistët klasikë, janë kundër ndarjes së popullit në klasa dhe luftës së klasave.

Populistët e majtë, në kundërshtim me principin e popullistëve të djathtë, të cilët i përjashtojnë shtresa dhe grupime të ndryshme sociale, janë për barazi dhe shanse të barabarta. Sipas tyre, të mirat materiale, duhet të ndahen sipas nevojave.

mendojnë për popullin, qeverisin me popullin dhe për popullin.

Qytetarët duhet të mendohen mirë, para votimeve, kujt duhet t'ia japin votën. Ndryshej do të vuajnë nga vendimmarrja e tyre.

Gjatë fushatës elektorale, duhet t'i hapin sytë dhe veshët mirë, për ato gjëra që shikojnë dhe dëgjojnë nga propaganda politike populiste.

Çfarë thotë ky njeri, ky lider?

Janë të mundshme të realizohen ato gjëra që premtion ky njeri, apo është thjeshtë një populist?

Mediat janë të shitura, në shërbim të forcave dhe grupimeve të caktuara politike. Duhet të mendohen aq të pabesueshme, sa dhe vetë populistët.

**Lekë Imeraj**  
shkrimtar, përkthyes, publicist

# ME RASTIN E FESTËS SË KARNAVALEVE

## Prof. As. Dr. ZEF GJETA, DJALI I DUKAGJINIT, QË ORGANIZOI KARNAVALET E PARA PAS RENIES SË SISTEMIT

### Historia e Karnavaleve të para të Venecias

Ishte viti 1296. Në Venecia, festa bëhet ligj. Senati i Republikës së Serenissima-s deklaroi ditë festive atë që i paraprin Kreshmës (sipas liturgjisë katolike, periudha e pendesës prej 40 ditësh në prag të Pashkëve, nga e mërkura e Përhimët deri të Shtunën e Shenjtë), duke formalizuar atë që tashmë është një traditë e rrënjësor prej shekujsh në Lagunë, Karnavalet.

Etimologjia e fjalës Karnavale, mendohet se vjen nga latinishtja *carnem levare*, që do me thënë eliminimi i mishit nga ngrënia, apo zakoni i ngjashëm në Greqinë e lashtë në nderim të perëndisë Dionis, apo të ritualeve atavike në festat romake, që përbënte në fakt të vetmen festë që festohej në të gjithë Perandorinë romake, ishte Evropa katolike ajo që e ripërpunoi festën e Karnavaleve mbi këtë substrakt shumë shekullor duke e futur në kalendarin e vet të krishterë. Përdorimi i maskave bënte të mundur krijimin e iluzionit tek njerëzit e thjeshtë, që ishte e pakontestueshme për ata që, për disa kohë do të zhdukeshin ndarjet shoqërore; nga ana tjetër, krijohej mundësia e përqeshjes e dënimit nëpërmjet talljes, e autoriteteve e të aristokracisë. Doxhi bëhej shërbëtor, e burri grua; nuk kishte më dallime, gjithçka lejohej, ishte bukuria e trashëgimisë, e të festuarit zemër lehtë të jetës. Por, me formalizimin e Karnavaleve nga ana e Senatit të Serenissima-s, në pikëpamjen politike kemi një moment, ani pse të përkohshëm, të një kryengritjeje të popullit ndaj shtypësve, që në Venecia ishte edhe më funksionale, duke vendosur kështu edhe kufijtë e disa çështjeve si morali i përbashkët apo rendi publik. Kjo është arsyeja pse forma e saj është e tillë, që të lejon të pish e të hash pa pasë nevojë ta heqësh. Pastaj vjen Gnaga, apo gruaja e thjeshtë e popullit me maskën e maçokut, e cila brend me një kosh në krah ku brenda mban një maçok që nxjerr tinguj të çjerrët e mjaulima tallëse. Me raste, ajo vishet edhe si mëndeshë. Por, pas maskës së macës në fakt fshihet një burrë i cili shoqërohet nga burra të tjerë të maskuar si fëmijë. Kurse Moretta (apo zeshkania) është një maskë e vogël prej kadifeje në ngjyrë të errët, e cila vishet me një kapele të vockël me tyl të rafinuar. Zeshkania apo Moretta është një shërbëtoreshë gati memece, nuk flet kurër, sepse maska që mban ka një komçë që ia pengon të folurit. Por festa e Karnavaleve shfrytëzohej edhe nga keqdashësit; me kalimin e kohës filluan vjedhjet, grabitjet e ngacmimet seksuale nën "lejen" e maskave. Kishte ndonjë madje që masakohej si frat për të hyrë në kuvendet e suorave... Kaq u vështirësua situata sa që autoritetet u detyruan të fusin gjithmonë e më shumë kufizime me anë dekretesh kundër abuzimeve e përdorimit mashtrues të maskimeve. Kështu, që nga 22 shkurti i 1339 do të hynte në fuqi ndalimi i qarkullimit me maska natën, kurse një dekret i

24 janarit të 1458 do të ndalonte plotësisht hyrjen me maska në vende të shenjta, me qëllimin që të shmangej kryerja e multas inhonestates (gjobave të pandershmërisë). Kishte raste të tjera kur mantelet përdorshin për të fshehur armët, andaj një dekret tjetër do të ndalonte mbajtjen e armëve apo të çfarëdo objekti me natyrë të rrezikshme për sigurinë e të tjerëve. Ato toleroheshin, por duke u konsideruar gjithmonë si burim mbartësesh të sëmundjeve shumë të rrezikshme si sifilizi, apo edhe si modele të këqija të sjelljes së pacipë. Meqenëse edhe ato përfitonin nga periudha e Karnavaleve për t'iu shmangur



kufizimeve që iu ishin vendosur, atëherë u vendos që të ndalohej prostitucioni me maska përpos se me gjoba tejet të kripura, por edhe me rrahje me kamxhik në publik duke filluar nga sheshi San Marco deri në Rialto, deri në dëbimin për katër vjet nga territori i Republikës veneciane. Por shpirti i vërtetë i Karnavaleve të Venecias, nuk u humb asnjëherë, duke qenë produkt i rrjedhojës së një kulture të jetuarit të Republikës më të fuqishme marinare, që zgjati 1000 vjet, ku niveli shumë i lartë ekonomik e pasuria përrallore e arritur ndër shekuj solli edhe rafinimin e manierave, në garën e fortë të kësaj feste shumëshekullore, në të gjithë botën, pa u zbehur aspak në shkëlqimin e vet. Mbase, ky vit i mbrapshtë nuk do ta lejojë shpërfaqjen e bukurisë veneciane të Karnavaleve me të cilën njerëzimi është mësuar ta përjetojë, por, tek e fundit, gjithçka është kalimtare, kështu edhe e keqja. Sa here dëgjojmë fjalën Karnavale ne mendojmë për Rio De Janeiro dhe njerëz gjysmë të zhveshur, që sfilojnë në rrugët e kryeqytetit me puplat dhe format shumëngjyrëshe dhe duhet kaluar momente fantastike.

A keni ndaluar ndonjëherë e të keni menduar nga cili vend ka ardhur ky festim dhe pse e festojmë atë? Fjala "Carnavale" do të thotë "evitare la carne" (të shmangesh ngrënia e mishit), vjen nga latinishtja: *carnes levare*. Në lashtësi kar-

navalet përfaqësonin rizgjimim pas sezonit dimëror, vitalitetin dhe visheshin si një shans për të larguar të keqen përmes lumturisë së momentit, me festa, me humor dhe me vallëzime. Ky term nisi të përdorej që në shekullin XIII, vetëm në disa qytete të Italisë dhe dalëngadalë u përhap në të gjithë botën e krishtere të kohës. Evropa, më vonë vendosi të shtojë karnavalet në kalendarin katolik, si një feste e vërtetë. Karnavalet nuk kane pasur asnjëherë një date të sakte dhe fikëse, pasi gjithmonë vareshin nga dita e Pashkëve të vitit pasardhës. Karnavali është një sezon festiv i krishtere që ndodh para sezonit liturgjik

studiuesi *Gjush Sheldia* (1902-1976). Ky mësues i një niveli të larte, studiues i zellshëm i historisë së karnavaleve, por që ka lenë pas studime dhe artikuj që duhen studiuar. Ai u përqendrua vështrimeve etnografike e kulturore. Përmes studimeve eksploroj doke e zakone, shkroi histori shkollash e dasmash malësore kryesisht në zonën e Dukagjinit, duke lenë pas një pasuri edhe nëpërmjet fotografive të rralla e të pa botuara më parë. Unë e njoha personalisht si një mësues i një niveli të epërm në pension, nëpërmjet dhëndëri tim Prek Gjeta, por më vonë e vlerësova akoma më shumë nëpërmes librit "Historia e Karnavaleve të Shkodrës".

Personazhi i dyte i pa "eksploruar" është *Prof. As. Dr. Zef Gjeta*, ideatori dhe realizuesi i karnavaleve të para pas rënies së sistemit monist, në vitin 1998. Mbështetur nga një grup i përzgjedhur artistesh dhe me ndihmën bujare të disa artdashësve shkodran, duke kontribuar financiarisht për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

### Fillimet e para

Me 1860, në Shkodër vijnë dy këpucare, hungarezi *Shtjefen Ingrid* dhe dalmati *Jovan Drogutinovici*, të cilët ju tregojnë punëtoreve të tyre zeytare se si kremtoheshin karnavalet, sidomos në Venedik. Të gjithë këta zeytare mezi prisnin fillimin e shfaqjes së karnavaleve. *Gjovani Kanale*, italiani, i cili drejtonte bandën e Arrës së Madhe dhe nga ana tjetër mjeshtrit e muzikës *Zef e Gjon Mala*, të martën e karnavaleve të vitit 1878, me te fillon veprimtaria plot gëzim. Disa fanatike i denoncuan në qeveri si veprime gjoja të turpshme dhe papritmas i shpërndau nga lagja Perash, dhe i paralajmëruan se në rast përsëritje do ti burgosnin. Por si njerëz të pa dëshiruar nga dy besimet fetare, pasaniket dhe vete qeveria turke ata i mërguan. Zefin në Cetine dhe Gjonin në Rjeke. Në vitin 1880, Jake Fishta e vazhdoi veprimtarinë me kërcime surle e lodër sipas melodive jevgjit. Zefin e Ndoc Fikut e Kol Zorrën i veshën si "dreqen". Maskat i merrnin prej Venedikut deri sa Gjoke Pici, marangoz i zoti dhe më pas Kole Indromeno nisen dhe i prodhuan vete maskat.

E bukura këtu qëndronte se, këta me disa shoke të ngushte visheshin si surreten tuj shetit nëpër miq e të afërm të tyre, kjo ishte një risi e veçante për kohën. Këto festime pritëshin mrekullisht nga masa, ndërsa të rinjtë dhe të rejtat kishin pak frike, por këto dite i pritnin me padurim. Ndonjë tregtar bujar dhe artdashës për ti marre për dreke, duhej të bënte porosinë me jave përpara për ti pronotuar. Zakonisht rruga që përshkonin ishte nga Ara e Cekes tek Arra e Madhe (sot shkolla Ndoc Mazi), në livadhin e Çobajve, në lagjen Badra deri tek rruga Marvukaj (sot shkolla Mati Logoreci). Kërcimin e pare e bënin tek Valija, Saraji (sot bashkia), vazhdonin me radhë te konsullatat e huaja nga ajo

### Historia e karnavaleve në vendin tonë

Është folur dhe shkruar shumë për historinë e zhvillimit të karnavaleve, por për dy personazhe, të cilët kane kontribuar në studimin dhe në zhvillimin e karnavaleve është folur pak ose aspak. I pari është



e Austrisë, Italisë, Ruisë, Francës, Anglisë, Malit të Zi e Greqisë. Në të gjitha këto konsullata gostiteshin me gjithçka, lloje ëmbëlsirash, por edhe me monedha. Konsujt dilnin të paret për ti përshëndetur duke i falënderuar për ditën e bukur të tyre. Këpucëtari Gasper Tusha, trupmadh dhe shumë i pashëm vishej e manipulohet i hipur mbi kalë, paraqitej si një nuse e jashtëzakonshme katolike Shkodrane. Tek Xhamia e Perashit disa persona i vunë armët surrave për t'iu grabitur nusen. Por Gaspri i zgjuar i joshi si një femër e vërtetë për të shmangur tragjedinë. Më pas, ky u thoshte shokëve: – ‘*Ju vraftë Zoti, si nuk e mbrojtët nusen, ishte rrezik me dek te tanë*’. Simon Shpori duke pasur kredibilitet të madh i mori një oficeri të larte turk rrobat ushtarake dhe doli në shfaqje. Ai u arrestua nga autoritetet. Ata dërguan Valiut. Simoni do të përballë me gjykatën ushtarake, por Valiu e shpëtoi sepse Simoni i tregoi në bese se kush ja kishte dhënë veshjen ushtarake, duke mos e ndëshkuar oficerin.

Në vitin 1895, Pjeter Dema ish shegert i Inglizit, ju lut Kole Indromenos, që t'iu ndërtonte surreten me pamje të mahnitshme, duke lenë shikuesit të habitur, ku fantazia e tij ishte e paimagjinueshme. Me date 1 Nëntor 1896 Jezuitet ndërhyjnë pranë pushtetarëve për pezullimin e karnavaleve, gjoja për banalitet, kjo ndërpreje zgjati për 4 vite me radhë.

Në vitin 1900, Shan Shpori e Zef Mhilli e rifilluan përsëri veprimtarin e karnavaleve. Krijuan disa figura njerëzish e kafshësh të pa para deri në atë kohë, por veshja e Kole Bardheci si arushë ishte e magjepsë. Kjo shoqëri vijoi veprimtarinë për 6 vjet nga Zef Mazi së bashku me Shan Shporin, Zef Mhillin, Gjush Pastaxhin me të vëllain, Toninin dhe Luigj Saraçin. Veprimtarinë e ndërpreu Lufta Ballkanike.

Zef Mani e filloi veprimtarinë me 1914. Ai mblodhi figura të spikatura si Gjoke Picin, poliedrik i rrallë, ai stampoi për here të pare flamujt kombëtare në Shqipëri, djali i tij, Toma i pat ruajtur këto forma stampimi. Gjok Pici me 1923 ndërtoi Urën e Zeze nen drejtimin e inxhinierit të njohur Spiro Koleka e më pas duke punuar si ndihmës i tij. Për shumë vite spikaten Zef Preka e Tish Matia. Me gjithë lutjet publike drejtuar autoriteteve pushtuese austriake kohen e Luftës së Pare Botërore u detyruan që të lejonin zhvillimin e karnavaleve mbasi forcat ushtarake mbeteshin të mahnitur.

Me 1919 organizator u bë Luigj Lacuku, i cili krijonte dhe botonte bejtet e karnavalit.

Në vitin 1922 personaliteti Zef Hil Gega e Frano Lleshi formuan grupin e Kole Indromenos, ku maskat dhe veshjet i prodhonte vete Kola.

Me 1921 grupi i Shoqërisë së Punëtorisë të drejtuar nga Ndoc Temalia, Kole Tivari dhe Laca i Gjon Laces i organizuan karnavalet për tre vjet me radhë.

Me 1924 u organizuan një grup të rinjsh i quajtur “Grupi i Matish Prendushit”. Ndërsa “Grupi i Gjon Krajnit me shoke”, deri në vitin 1929. Këtu maskat u paraqiten mjaft moderne, në të cilat Gjoni thurte recitale e bejte. Vijimësinë e vazhdoi shoqëria “Rozafa” e drejtuar nga Kole Shurdha, i cili shquhej për satirat e bejtet kundër regjimit. Kola u largua nga Musa Juka, objektet që ky shpiku ishin nder për

Shkodrën.

Nga vitet 1936 deri me 1938 ishte “Grupi i Punëtorëve” nga lagja Arra e Madhe, nen drejtimin e Marka Dodes, që ndoqi traditën e Fishtajve, por me pushtimin fashist, me urdhër u ndaluan rreptësisht karnavalet deri mbas çlirimit.

Në vitet 1951 deri me 1957 për here të pare i organizoi Shtëpia e Kulturës, ndërkohe që këto karnavale u cilësuan si më të mirat nder vite. Duhet theksuar se karnavalet u zhvilluan edhe jashtë qytetit. Shiroka ishte i vetmi që i organizoi edhe në kohen e pushtimit fashist. Ato u organizuan nga Loro Tarraku nga viti 1935 deri me 1950. Ato u organizuan edhe në zonën e Dajçit.

Një shekull më pare, 40 dite mbas karnavaleve katolike pjesa myslimanë kremtonte “Teferiçin” në livadhin e “Sokolajve” ku turma djemsh e burrash bënin qejf duke hëngër e pire deri në perëndim të diellit. Mbas Luftës Ballkanike e kremtja e Teferiçit në stil më të gjere behej prej anës myslimane me datën 6 Maj, ditën e Shën Gjergjit. Këtu shkonin grupe kalorësish e



këmbësoresh në Tyrbe të Drishtit, për të festuar ditën e Pranverës. Në vitin 1950 edhe ky rit u hoq nga qeveria.

Padyshim, në organizimin e karnavaleve, podiumin i nderit ju takon bejtexhive. Në këtë zhanër Shkodra është e spikatur. Bejtexhit më të spikatur nder periudha të ndryshme janë: Molla i Sali Pates, Kasem Ahuri, Osja i Faltores, Kole Karabegu, Ndoc Kajelli, Lushi i Palok Qorrit, Kola e Hila i Files, Gjushi i Lec Kirit, Ndrek Prekula, Gjon Topçija, Gjon Çela, Luigj Lacuku (Topalli), Simon Çiurçia, Ndoc Temali, Gjon Krajni, Luigj Zadeja, Matish Prendushi, Zef Hilgega, Nush Pali, Palok Gjushi, Kole Topi, Kole Tivari, Ismail Barbullushi. Këta bejtexhi pasohen nga: Gjon Kole Doja, Gjon Kraja. Ndërsa gjenerata e fundit e shekullit të kaluar janë: Loro Kovaçi, Simon Rranzi, Ndoc Tivari, Shuk Radoja, Marka Doda, Kel Çela, e Rrok Nushi. Dua të theksoj, se pas kësaj plejade ka pasur, ka edhe sot bejtexhi të njohur, por kurrsesi në nivelin e këtyre, paraardhësve të tyre.

#### Organizimi i karnavaleve të para pas Pluralizmit

Personazhi tjetër që ka organizuar kar-

navalet, në vitin 1998, për here të pare pas shumë vitesh, në Shkodër, me nismën e një grupi krijuesish të qytetit tonë, kryesisht të dy shoqatave kulturore në këtë qytet, ne drejtimin e zotit Zef Gjeta. Çuditërisht, megjithëse më vonë janë botuar edhe libra, të cilat i referohen karnavaleve nder vite, asnjëri nuk e përmend nismëtarin dhe realizuesin e të parit festim të karnavaleve pas rënies të murit të Berlinit, në vitin 1998. Organizimi i kësaj veprimtarie ishte i bazuar thajse tërësisht mbi baza vullnetare. Pra, ndryshimi në mes manifestimit të vitit 1998 nga ata pasardhës ishte krejt i ndryshëm. Është për tu habitur, që sot nuk vërehet vijimësia, nuk ka një trupe që të kujdeset për zhvillimin e tyre çdo vit, të hartohet skenar dhe të kryhen interpretimet ashtu siç i ka hije Shkodrës dhe siç e duan shkodranet. Shkodra është njohur për kulture, e cila ka nxjerre figura të shquara, që e kane përfaqësuar dhe i kane dhënë emër.

Në aspektin kulturor, i trashëguar në Shkodër janë edhe karnavalet. Shkodra është qyteti i pare ku janë festuar ato, por njëkohësisht është edhe qyteti që i ka manifestuar më cilësisht ato.

Në fillim-vitet e shekullit të XX karnavalet morën formën e një manifestimi popullor. Por me ardhjen e sistemit totalitar u munduan që edhe karnavalet të bënin “tribuna” të propagandës. Për këtë arsye këto erdhën duke u shuar, deri sa nuk u festuan më. Sistemi ndryshoi, por tradita ishte zbehur. U deshtë të vinte viti 1998, kur në Shkodër të zhvilloheshin për here të pare karnavalet pas pluralizmit.

Organizimi i Karnavaleve në Shkodër gjithmonë është organizuar “Të martën e të Lidhurave”, që ka të beje me Kreshmët (agjërimin), periudhe që zgjat për 40 dite. Duhet theksuar se, kjo e marte nuk është fikse për çdo vit. Ajo ndryshon dhe ka një limit të caktuem. Asnjëherë nuk bien përpara datës 10 shkurt dhe mbas datës 10 mars. Pra, çdo vit karnavalet festohen në stinën e dimrit.

Në vitin 1998, për here të pare pas shumë vitesh ndërpreje, në Shkodër u zhvilluan Karnavalet. Kjo erdhi me nismën e një grupi krijuesish, intelektualësh dhe biznesmenësh të qytetit të Shkodrës dhe me mbështetjen e dy shoqatave kulturore të qytetit tonë, por që gjeti një përkrahje dhe mbështetje të menjëhershme nga ata që do të ishin pjesëmarrësit e këtij manifestimi të këndshëm, duke bere të mundur të rikthehet tradita e karnavaleve në qytetin e lindjes së tyre, në Shkodrën e lashtë.

Puna u përqendrua njëkohësisht në disa drejtime: Fondacioni SOROS dhuroi një financim modest, por forcat krijuese vullnetarisht krijuan libretin, u caktuan rruga i lëvizjeve, u përzgjedhën interpretuesit, u bene provat e nevojshme për një paraqitje sa më dinjitoze. U siguruan maskat dhe shumë veshje, u stilizuan makinat dhe pajtoni që do të ishin në krye të karvanit në Qendër të qytetit dhe në shumë vende publike u vunë njoftime se, me date 20 shkurt 1998, në orën 11:00 do të zhvillohej festa popullore e karnavaleve. Manifestimi pati shumë sukses, masa e madhe e të rinjve, të cilët mbushen sheshin në qendër dhe rrugëve shikonin karnavalet për here të pare. Nga të gjithë pjesëmarrësit u shpreh

dëshira që kjo veprimtari të jete i përvitshëm dhe të ketë pjesëmarrje sa më të gjere në të ardhmen. Për këtë ishte e domosdoshme sensibilizimi i opinionit dhe në mënyre të veçante të gjendeshin më shumë burime financimi.

Organizator dhe regjisor i kësaj veprimtarie ishte Zoti Zef Gjeta, mbështetur nga aktori Frederik Fistani. Teksti u përgatit nga Zef Gjeta dhe Isa Teli. Interpretuesit e karnavalit të vitit 1998 në Shkodër, ishin një grup i përzgjedhur artistesh të qytetit: Ramiz Rama, Shqipe Malaj, Anton Krosaj, Gjovalin Sukaj, Irena Lorja, Paulin Pepa, Mirjan Bruçeti, Rajmonda Marku, Isa teli e Nexho Shabani. Për mbarëvajtjen e kësaj veprimtarie kulturore ofruan ndihme të pa kursyer zotërinjtë Pjeter Gjeta, Bexhet Bushati, Arson Rama, Rovena Bregu, Sokol Kroni, Arben Bobnaj dhe Leon Jaku.

Po botojmë disa nga vargjet e interpretuara:

Mirë se vjen o karnaval,  
urojnë sot pleqt’ e trijte,  
mirse vjen ti në Shkodër  
se për ty fort jem’ mërziute.

Tash 50 vjet, na ke harrue,  
e te na ti nuk ke ardhë  
patëm frige mos je idhnue,  
hajde pra ti ardhsh i bardhe

Gjithë k’to vjet që s’jena pa  
kena shumë’ për me t’kallzue  
kalon koha e s’ka me i la  
por s’po dim kah me fillue.

Dikur vijshë ti në Shkodër,  
maska n’fytë si surreten,  
kange, humor, valle e lodër,  
Oh sa na zbukurojshe jetën.

T’zbukurun’ e t’ dhanë jete  
nëpër vite shumë shkodrane  
me i përmend’ s’është’ e lehte  
e ketë pune na s’po e lame.

Me u kujtu tan’ shkodraneve  
si këndohej krejt përsmarit  
si në dite të zakonshme,  
aq ma shumë’ n’ atë t’ Karnavalit,

Me e ringjalle prape traditën  
që e pat’ populli shkodran,  
me e fillu përsmarit ditën,  
Kol Shirokës fjalën ia lame:

Karnaval mu m’ka met nami,  
por ju gati m’patet harrua,  
erdhi devri dhe zamani  
me kthy prape me knaq me ju.

Libreti dhe materiali i veprimtarisë u botuan në mënyrë të përmbledhur, në një botim të veçantë me titull: “Karnavalet e vitit 1998 në Shkodër”.

Ndoshta është momenti që t’iu kujtojmë disa “qytetareve”, të cilët me keqdashje harrojnë të shkruajnë për historinë e karnavaleve nder vite se, organizator i një prej veprimtarive, ndoshta më i veçanti dhe më i rëndësishmi ishte organizuar nga një djalosh intelektual, me prejardhje nga Dukagjini.

**Mark Bobnaj,**  
mjek stomatolog e studiues.

# DJEGIA E SHOSHIT DHE SELISË KISHTARE ME 7 SHKURT 1761

“Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit”, është njëri nga dhjetë kapitujt e librit “Kontribute për historinë Kishtare të Shqipërisë së Epërme të shekullit XVII-XIX, të historianit arbëresh Italo Sarro. Studimi i tij është një përmbledhje koncize e Relacioneve në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan. Libri meriton një analizë analitike në kontekstin historik të një periudhe dy shekujsh dramatike, gjakësore, me grabitje shtazore, por edhe të qëndresë drakoniane për ruajtjen lirisë dhe besimit nga agresioni frontal konvertues me shpatë dhe uratë. Autori flet pak e saktë me gjuhën e dokumenteve burimore, të cilat duhet pranuar se janë disi të thata e skematike, më tepër të karakterit fetare se sa të natyrave historike apo fushave të tjera të diturisë. Kapitulli Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit nuk është pa i njohur në rrethe shumë të ngushta studiuesish. Në mënyrë tangenciale si ngjarje e kam trajtuar edhe te Monografia “Shoshi”, por për mungesë të dhënash nuk jam futur brenda guaskës së kësaj ngjarje. Lajmet mbi këtë ngjarje të bujshme të kohës rezultojnë se janë përcjellë Republikës Venedik nga Zv/konsulli i Venedikut në Shkodër, Anton Duoda. Djegia Shoshit dhe qelës së tij kishtare është krye ngjarja më sublime, në historinë e qëndresës kundra islamizues në Dioqezën martire të Pultit.

## ÇFARË NA REFEN SARRO

Në vitin 1760 Stambolli kishte caktuar çmimin e detyrës të Pashës që ishte 25 mijë ZEKINA për zonën e Dukagjinit. Kjo betejë për këtë post u fitua nga prej Karamaninit (Në popull dhe tek ndonjë burim tjetër thirrej (Karamuçolli). Ky mizor i korruptuar (nënvizimi im) gjeti dikën që ja dha borxh paratë e postit për me i derdhe në Arkën e Stambollit (Perandori sa madhe e luftarake po aq korruptuar po nënvizimi im). Pasha, për të nxjerrë paratë e veta filloj plaçkitjet më dhunë ndaj pronës së malësorëve, por edhe me rrëzimin e objekteve të kultit të moçëm arbërorë. Autori shkruan. -“Pasha në krye të një ushtrie 10 mijë osmanësh dhe renegatësh filloi operacionin e haraçit për çdo shtëpi”. Grabitja e banesave u bë nga që malësorët kishin vonue shlyerjen haraçit ose nuk ishin bindë. Shpesh këta administratorë të “paqësorë” organizonin ndjekje që përfundonin me kapjen e atyre që kishin ikë vetëm për të mos pague haraçin. Në tilla raste fatkqet i dërgonin në Pejë, në Sarajet e Pashës ku kalbshin në burg deri kur familja të derdhte shumë e kërkuese. ... Katundet, të cilave Karamanini u kishte çue fjalë të parëve u shkelën me ushtri. Nikajt u detyruan të paguanin 1400 REAL, Shala 1300, Plani 800, Xhani 500, Palçi 400, Toplana 300. Populli i Shoshit dhe i Kirit tue kene të

varfër nuk pranuan, por nuk pritën me u zanë rob e me i çue në vargoj në Pejë, por ikën te Pasha i Shkodrës, duke kërkuar ndihmën e tij. Pasha i Shkodrës sado që u tregua i hapur sa që i priti në qytetin e tij, prap se prap nuk mund ndalonte dorën e tjetrit (Begollajve). Karamanini (Karamuçolli) mbasi mblodhi një ushtri të madhe hyri në dioqezën e Pultit i vendosur me ba Shoshin dhe Kirin shkumb e hi. Për gjatë rrugës shumë pultjanë që nuk kishin mbërri me ikë i mori peng. Pasi shkretoi Kirin dhe zgjeroj radhët e veta e mësyni Shoshi me 7 të frorit 1761. Sulmi që vërtetë mizorë duke djegur gjithçka, kishën, hospicin e fretërve të vegjël kuptohet dhe krejt katundin. Flakët e zjarreve dhe krejt lugina e masakrueme nuk mjaftuan me ja shue zemërimin pashës, i cili u lëshua edhe kundër françeskanëve. Këta u dorëzuan vullnetarisht si pengje, që dhuna të merrte fund. Por prape se prape, u rrahën, u morën zhag nëpër rrugët e katundit lakuriq, kambë zbathtë mbi borë dhe në fund i dënuan me vdekje. Vendim që ndoshta për shkaqe të rendit publik duhej të ekzekutohej jo aty por në Shalë. Këtu robërit i çuan te Velati Peci (Them se duhej shkruar Vlad Peci), i cili ndërhyri dhe i shpëtoi nga që ishte mik i Karamuçollit. ... Një vend të veçantë në këtë kapitull zë edhe mbajtja peng e një xhako 9 vjeçare të quajtur Jak Tuci që pas një maratone të gjate vuarjtësh dhe guximi të pa shoq, u lirua pasi prindërit dhe afërmit paguan 300 real.

## ÇFARË NUK THOTË ATORI

Autori as një herë nuk gjykohet për çfarë nuk thotë. Ai, edhe ma keq ka nxjerrë në cuhal mes diellit një xhevahir historik. Sarro natyrisht i qëndron besnik relacioneve që ka gjetur në arkiv. Në relacion nuk thotë se si quhej kisha Shoshit, që u dogj, por ajo dihej vetvetiu ka qenë Kisha Shedreut në fshatin Gurë, si kryeqendër e Arqipeshkëvisë së Pultit. Autori duke qenë arbëresh i vjetër nuk ka qenë kurrë në Dukagjin, por ndoshta as në Shqipëri dhe veç dokumentin nuk kishte ndonjë njohuri për këtë ngjarje. Dokumenti gjithmonë është një piketë, e burimit pastaj se nga rrjedhe e ku derdhet është çështje tjetër. Dokumenti për një studiues thotë shumë çka por jo gjithçka. At Zef Arapi në përmbledhjen e tij “Dukagjini në dokumente historike” nënvizon se: “Beglerët e Pejës e patën djegë Shoshin tre herë, pse nuk ndijoi me u nda prej Shkodre. Qindresë të madhe pat ba Shoshi në Forcë të Palajve e në Komlem të Shoshit. Qëndresa zgjati aq shumë sa

kan le 36 djem brenda kalasë (kala natyrore nënvizimi im). Këtu gjenden edhe sot rrënojat”(Zef Arapi Dukagjini në dokumente historike. AMHSH fq. 21 i dorëshkrimi i daktilogruar)

Studiues i mirënjohur Dr. Mark Palnikaj prej ashtës së Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan ka nxjerrë në dritë një dokument tjetër me rëndësi që përket viti 1732, që flet për digjen e kishës, banesave dhe prerjes së pemëve të Shoshit.



Dokumentit që na ka zbuluar Palnikaj me 26 janar 2012 na rezultojnë tridhjetë vite më hershëm se ai që ka botuar Italo Sarro, por që indirekt na konfirmon se Shoshi dhe qela e saj është djegur më shumë se dy herë, pse jo tre ashtu siç citon At Arapi, pa përcaktuar tre kohërat e shkuara.

Arratisja e shoshianve ka qenë biblike masive drejt shpellave të Karmës së Palajve dhe Komlemit. Ka qenë dimër i tmerrshëm, borën e kanë çarë me rrathë dhe ky ka qenë shkaku që i kanë shpëtuar asgjësisht të plot. Fatkeqësisht deri më sot nuk kemi ndonjë dokumente sa ishte numri tymeve as i banorëve të Shoshit në vitin 1761, por dhjetë vite me vonë me 1771<sup>1</sup> Shoshi kishte 135 shtëpi dhe 835 banore. Për analogji vetëm demi në banesa pa frikë e kaluar pragun e një numërori tre shifrorë. Me 1972, për herë të parë kam dëgjuar 100 vjeçar, Zef Gjeshi i nga Lotajt e Shalës, i cili duke falë më gjyshin tim tregoi historinë e Karamuçollit. Zefi kishte një mënyrë të treguarit dhe të interpretuarit sa ngjarjen ta sillte përpara syve sikur po luhej në real teatrin e qëndresës së moçme. Nga At Arapi dhe kujtesa popullore ka mbetur e skalitur në shkëmb se gjatë rrethimit është varë Ndre Buxha nga Ndreajt. Operacioni ka vijuar ethshëm për disa kohë. Në synim të realizimit final u ndërtua Ura e Pejës në fshatin Pepsuj nga kanë kaluar mushkat me mortaja dhe poshtë fshatit Mollë nga Nënplepi është quajtur breshërisht Komlemin me topa të kalibrit malorë. Vendi ku flakëronin gjylet thirret që

atëherë edhe deri më sot Curri i Topit. Aventurën e çmendur shfarosëse Haxhi Begu e pagoi me kokë, prandaj vendi ku u sos, quhet shkëmbi i Haxhi Begut.

260 vjet kanë kaluar dhe kjo ngjarje që as një herë nuk harrua në kujtesën popullore, por mbijetoj e veshur me aureolën e një misticizmi legjendar. 260 vite në terrin e herezisë dhe pa përgjegjshmërisë as një herë nuk u vlerësua as nuk u ngrit në panteonin që meriton. Kjo ngjarje është një epike qëndrese e martirizimi që matet me malet. Kjo ngjarje është elegji për gjakun e derdhur dhe sakrificat mbi njerëzore të shqipeve të Lekes, është lapidarë historie në altarin e kryqit të pa thyer. Larg çdo sentiment kjo ngjarje është dekoratë e klasit të parë për Shoshin primarë në gjitha ngjarjet kapitale të historisë së Dukagjinit. Kjo ngjarje nuk mund të anashkalohet as të belbëzohet për nën hundë, si deri më sot. Ajo duhet të zënë vendin që i takon

në kalendarin e liturgjisë historike të Dukagjinit dhe me gjerë. Djegia e Shoshit dhe Selisë Kishtare, në shkurt 1761, po ashtu edhe Kirit, duhet vlerësuar jo për mendshijtje krahinore, por si mirënjohje për një emblemë të vjetër, që i bën nderë historisë së Shqipërisë në radhe të pare, pastaj dhe Kishës katolike shqiptare.

Shoshi nëse ka nderim për vlerat të parëve dhe besimit të tyre të ngulitur në shkëmb, duhet ndërtoi një objekt memorial, ku çdo vit të behet një pelegrinazh përkujtimore dhe ta pasqyroj në këngë, poezi dhe art.

Kjo periudhë duhet studiuar më themel, analizuar edhe pasuruar në dritën e fakteve të reja duke precizuar edhe një ose dy rastet e ngjashme si kjo, që tashmë e ndriçuar nga dielli i historisë. Kur them Shoshi nuk lëçis askënd tjetër, por kjo gjë i përket më shumë se kujtdo, rinisë mërgimtare. Ndërsa ne, forcat intelektuale jemi gati kurdoherë ashtu si deri më sot, por makina pa karburant nuk lëvizë. Tashmë për këtë periudhë sa e errtë, por edhe të ndritur nga studiuesi Mark Palnikaj, ka mbushë një “zhabë” me dokumente të Arkivit të Vatikanit, që i ka mbledhur me zharkun e tij pasionant me sakrificë e kosto financiare kohore dhe udhëtimesh. Ato dokumente duhen botuar, njohur, vlerësuar si nga visaret më vlerat të Dukagjinit të epërm.

Mjaft më me këngë qesharakë për heroi të rremë që denigrojnë të vërtetat, ndërkohë që te vërtetat identitare mbetën sirtarëve të ndrymë me dry.

1 H. Hequard “Shqipëria dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme” bot 2008, fq 149

# MEDIAT DHE ÇENSURA

Së pari, ngjarjet e shumta e të përditshme politiko-sociale, të cilat ndodhin është e arsyeshme që opinioni, të tregojë interes, bazuar vetëm mbi fakte, parësore që informacioni të jetë i vërtetë. Së dyti, në opinionet apo analizat të kenë objektivitet.

Kontributi i medias në të dyja këto prishmëri që shoqëria ka, luan një rol të pa zëvendësueshëm. Dhe jo më kot quhet pushteti i katërt, krahas pushteteve të tjera si (ai legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor). Ama, konsolidimi i pushtetit të katërt në shërbim të tre pushteteve të tjera është jetik. Mediat e shkruara në gjuhën shqipe e kanë zanafillën herët: Gazeta "KOMBI" e botuar në SHBA, në vitin 1906, gazeta "TARABOSHI" e botuar në Shkodër. Numerik i pare i saj doli me 26. 09. 1913, shtypur në shtyp-shkronjën Italo - Shqiptare, me pronar Torenc Toçi, e kryeredaktor të madhin Atë Gjergj Fishta. Krahas shtypit të shkruar (ndonëse me vonesë nga vendet e tjera), me 28 nëntor 1938 fillojë transmetimet Radio Tirana. Në vitin 1960 fillojë transmetimet Televizioni Shqiptar, i cili ju bashkua Radio Tiranës. Ç' ka i dha pasurim informimi e redaktues, të larmishëm e të publikut Shqiptar, pse jo edhe jashtë atdheut me stacionin e Shijakut. Në ditët e sotme numërohen rreth 83 media që operojnë në Shqipëri. Me frymë gjithë përfshirës publicistike, kombëtare dhe private. Të sakta, por edhe zjarrndezëse!

Pushtete diktatoriale në vizionin e tyre kanë privatizimin e këtij pushteti në shërbim të sundimit tyre mediatic sa më gjatë!? E nëse doli nga rreshti ndonjë medie, ajo anatemohe deri në faliment-

timin e saj. Kjo te ne është provuar për 50 vjet, aq sa ishte e ndaluar të dëgjojë në: Radio "Zëri i Amerikës", Radio "Vatikanin", BBC-e të tjera. Me gjithë terrorin dhe frikën ato janë dëgjuar pothuajse në 70 për qind të popullit, por kurrë vetëtimën se ka fikë era. Asnjë diktaturë nuk ka mundur të shuaj mendimin e mediat e lira. Edhe në diktaturë mediat janë ndjekur, pavarësisht se po të diktoheshin i priste burgu, bazuar në nenin famëkeq "Agjitacion e propagandë". Kur kthehem pesë dekada më përpara që kam dëgjuar për here të pare "Zërin e Amerikës" në shtëpinë e një të burgosuri politik (i sapo liruar nga burgu i Burrelit), kushëri i yni dhe quhej Nik Sokol Bosh, i ora 18 më tha: A ke qejf me dëgjua radio "Zërin e Amerikës"? Po!- ju përgjigja. Po me një kusht: Mos me ba bisede me asnjëri! Ju betova se nuk do ti tregojë askujt.

Gazetari në mes të tjerash theksoj: "Në Shqipëri po përgatitet ligji për mbylljen e kishave e xhamive dhe arrestimin e klerikëve!?" O zot, ç' bëhet?! Shpallja e Shqipërisë si vend ateist i pari në botë. Na tha Tata (siç e quanim ne ), se në orën 21.00, do të dëgjojmë "Radio Vatikanin"! Për koincidencë, lajmet i përcillte Atë Daniel Gjeçaj nga Thethi, i emëruar nga Selia e shenjte, përfaqësues shpirtëror i Shqiptareve katolik në mërgim. Pasi mbaruan lajmet, serishmi flitej për mbylljen e kishave e xhamive. Tata më tregojë se si ishte arratisur nga fshati Plan i Dukagjinit për në jugosllavi. Ishin burrat e Planit ata të cilët e sinjalizuan se do ta arrestonin. Dhe për të mos e prerë në besë e shoqëruan deri sa kalojë kufirin. Duke rrezikuar edhe jetën, që famullitari

i fshatit të tyre të arratisesh pa e arrestuar. Le të lemë pas regjimin diktatorial. Rikthehem në këto vite të tranzicionit. Mediat kanë qenë të sulmuara vend e pa vend, sepse nuk kanë qenë në shërbim të pushtetit. Pushtetarët tanë e kanë shumë të vështirë të shkëputen nga simptomat e pushteteve diktatoriale. Duke sulmuar mediat e lira, me qellim që të mbyllin gojën për skandalet e korrupsionet të qeverive, pa bë dallime për asnjë qeveri në të gjitha këto vite të tranzicionit?!

Fenomen ky që na ka shoqëruar tash 30 vite të tranzicionit. Le të kujtojmë se si u dogj selia e gazetës "Koha e Jonë" apo se denoncojën renjen e firmave piramidale? U paralizuan dhjetëra gazetarë, vetëm e vetëm se raportuan me objektivitet të vërtetën. Ashpërsimi i luftës kundër mediave ka arritur kulmin këto vitet e fundit. Mediat, janë pagëzua me turlu lloje etiketimesh, nga pushteti: "kazanë", opinionistët "Kadri", "fallxhorë" e të tjera. Dhe jo veten mediat vendase, por edhe ato ndërkombëtare. Ndonëse janë media prestigjiozë, si "Zëri i Amerikës" e futen në kazan sepse, denoncojën hijet e korrupsionit e të krimin të organizuar, krimet elektorale. Në mes të cilave mund të theksojmë korrupsionin me Unazën e re, Teatrin, rrugën Milot- Balldre, krimet elektorale në zgjedhje, veçanërisht dosjet 184 e 339 e të tjera. Ky qëndrim ndaj mediave na kujton deklaratën e shefit SHIK-ut në parlament, pas rënjes së firmave piramidale. "E quajti BBC si pjesë të komplotit për të rrëzuar qeverinë, siç u veprua para disa kohësh me Televizionin "Agon Çenell", pronari i të cilit ishte Begeti. Fitoj gjyqin e Qeveria Shqiptare

do ti paguaj rreth 140 milion ero, ose 300 ero për çdo familje Shqiptare. Krahas kësaj mbeten rreth 500 punonjës pa punë. Mbyllja e këtij televizioni u bë vetëm se kishte marrë pozicion kritik ndaj qeverisë. A ma, këtë gjobë do ta paguajnë taksat e shqiptareve. Disa raporte vendase, madhe edhe ndërkombëtare kanë kritikuar qëndrimin e pushtetit ndaj mediave. Shpesh kanë ngulë këmbë për mos miratimin e ligjeve, të cilat bien ndesh me liritë e mediave. Pozicioni i gazetarëve në Shqipëri është i rëndë. 90 për qind e tyre janë pa kontratë pune. Pronarët e mediave e kanë më lehtë të bëjnë presion mbi gazetarët. Për të dhënë ose jo lajmet, sidomos për ato që bien ndesh me veprimet anti ligjore të pushtetit. A nuk ishte censurës ligji për shpifjet?! O zoo-t!

Gazetarët përveç censurës nga pushteti, vuajnë edhe antiçensurën nga pronarët e mediave. Sindikatat e gazetarëve nuk janë efikase, madje ndihen shumë pak. Po thuajse janë bërë njësh me pushtetin. Kjo nuk është e përgjithshme. Ka plotë media, të cilat i qëndrojnë censurave. Ka shumë gazetarë, të cilët nuk përkulen as nga vetçensura e pronarëve të mediave. Me gjithë presionet ata kanë thënë me zë të lartë e objektivitet të vërtetën. Pushtetarët i kanë mohuar të gjitha me llafollogji të stërholluara, me qellim të mbulojnë të vërtetën. Problematikat e denoncuar nga mediat kanë rezultuar të vërteta. Nuk po i rendisim se duken faqe tëra, se gama është shumë e gjere. Pushtetarët nuk i pranojnë. Harrojnë se media e lire është jetike. Sa s' është vonë duhet vlerësuar, përkrahur dhe inkurajuar në shërbim të demokracisë për lexuesit, e mbarë opinionin.

**Përgatiti:  
Ndue Ziçi**

## VAJZA 11 VJEÇARE QË PO LËVRON NË ZHANRIN E POEZISË DHE VJEN ME NJË BOTIM POETIK

**Besarta Gjovalin Shkoza**  
**Origjina e saj nga Camaj, Dukagjin**  
**Banuese në Torovice, Lezhë**

Eshte me prinder nga Camajt e kra-hines së Shalës në Dukagjin, banon në Tarovicë, eshte e talentuar, në moshën 11 vjeçare ka botuar vëllimin poetik , me titull "PUNËTORE SI BLETA"

Një vëllim plot tema interesante, me brendi të jashtëzakonshme për moshën. Dhe vijon punën pareshtur për vëllimin e dytë.

Vogëlshja Besarta është inteligjente, e urtë dhe e dashur, ku krijimtaria duket se po i lëvtron ndër deje, e them kështu sepse ka guxuar tashmë në një tjetër zhaner siç është edhe Eseja.

E prekshme tashmë pasi Eseja "Udhëtim në Thethë" iu botua në "Antologjinë METAFORA"

nga shkrimtari i mirënjohur Gëzim Ajgeraj.

Më së miri e them se kjo nxënëse e klasës pestë në Kolajak të Lezhës, sapo ka nisur udhëtimin e saj të gjatë në Letersinë

Shqiptare.

Ndonëse vjen pors një perlë mes moshatarëve, duke u bërë frymëzim për gjeneratat, pasi libri është dije, kulturë e njohuri.

Është i pazëvendësueshëm me asgjë.

I urojmë Besartës shumë suksese e Pena mos ti pushoftë e boja mos ti shterojë kurrë.

**NGA PRENDA SEJDIA**



# Atletika shqiptare në zi.

## Ndahet nga jeta në moshën 77 vjeçare ish kampioni dhe rekordmeni shkodran, Llesh Vuksani

Shkodrës, por edhe Shqipërisë po i largohen pak nga pak yjet e sportit, ato që në vite dhe dekada kanë qene protagoniste në garat kombëtare, dhe po ashtu edhe ndërkombëtare. Njëri prej tyre që u nda këto ditë nga jeta, në moshën 77 vjeçare është ish kampioni dhe rekordmeni i famshëm i atletikes shkodrane dhe asaj shqiptare, Llesh Vuksani. Falë fizikut të tij të përsosur, shtatlartë dhe shumë i fuqishëm, Llesh Vuksani në rininë e tij që spikaste ndër djemtë simpatikë të qytetit verior dhe më gjere, aplikonte me shumë sukses sporte të ndryshme. Por, nisur nga të dhënat e tij fizike, atletika ishte ajo që kërkoi dhe preferoi ta bënte të vetin. Kështu që, trajnerët, mes të cilëve edhe Syrri Hoti e orientojnë për në disiplinën e hedhjeve, aty ku me shtizën e tij do të bëhej një kolos i vërtetë i kësaj discipline dhe i sportit të atletikës në përgjithësi.

### Karriera

Zyrtarisht me ekipin e atletikes së “Vllaznisë”, Llesh Vuksani do të bashkohej në vitin 1965 duke u bërë një nga shtyllat kryesore të klubit shkodran, ku me rezultatet e tij tejte cilësore ai kontribuon në fitimin e shumë trofeve kuqe blu. Duke nisur nga ky vite dhe deri në fund të vitit 1975, Llesh Vuksani do të ishte kampioni dhe rekordmeni absolut i atletikes shqiptare. Përpos fitimit të 5 titujve kampionë si individë si dhe atyre ekipor, me emrin e Llesh Vuksanit lidhen edhe një numër i madh rekordesh kombëtare, një pjesë e të cilëve i kanë qëndruar kohës edhe për shumë vite më pas, madje ka prej atyre që akoma janë në fuqi edhe sot. Janë vite kur së bashku me të konkurronin edhe emra shumë të njohur të atletikes shkodrane, si Hysni Bebeziqi, Isak Bala, Nazmi Kryeziu, Gëzim Mema, Kujtim Rrjollli, Dashamir Sherja, e të tjerë. Karriera e ndritur sportive e Llesh Vuksanit lidhet edhe kontributin e dhënë për ekipin kombëtar të Shqipërisë, ku në vitet e tij të aktivizimit emri i tij ishte përherë ndër titullarët kryesorë të përfaqësueses së atletikes kuqezi.

### Trajner dhe gjyqtar atletike

Ndërkohë, që pas largimit nga konkurrimi si sportist, krahas misionit të nderuar të mësuesit të edukimit fizik, Llesh Vuksani do t'i besoj edhe detyra e trajnerit ku gjithë talentin dhe përvojën e fituar si sportist, ai do t'ia përcillte brezit të rinj, një pjesë e të cilëve u bënë kampionë dhe rekordmenë të shquar në disiplinën e hedhjeve dhe posaçërisht në atë të shtizës që ishte edhe specialiteti kryesor i tij. Ishin vite kur ai drejtonte grupin e hedhësve të “Vllaznisë” përkrah kolegëve të nderuar, si kryetrajnerit Syrri Hori, Rasim Kraja, Gëzim Mema, Hysni Bebeziqi, Vildan



Tufi, Enver Dervishi, Kujtim Rrjollli, Rrok Hila, që më vonë do të ishte edhe në cilësinë e drejtuesit të klubit, e të tjera.

Pjesë e karrierës së tij sportive është edhe periudha si gjyqtar i atletikes, detyrë

të cilën, si një person shumë korrekt, brenda dhe jashtë sportit, ai do ta kryente në mënyrën më shembullore dhe profesionale. Ndërkohë që nuk duhet lënë në harresë edhe aktiviteti i tij me Shoqatën e Veteranëve të Atletikes, ku duke konkurruar me grupmoshat e tij, ai u bë fitues i shumë medaljeve në aktivitetet ndërkombëtare, evropiane dhe deri në SHBA. Por, krahas të tjerave, Llesh Vuksani njihet edhe për pasionin e ujit, ku kryesisht zhytja ishte specialiteti i tij, ku merrte pjesë shpesh herë në garat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare amatore që organizoheshin në këtë disiplinë. Zhytjen nën ujë, shpesh herë e përdorte edhe për pasionin që kishte edhe për peshkimin duke përdorur në mënyrën më të mirë pushkën e ujit.

### Konsideratat e kolegëve për Lleshin

Bashkëmohatarët e tij, kolegët me të cilët ai garoi si sportist, por edhe nxënësit

dhe sportistët që ai pati rastin të stërviste, shprehen me vlerësimet më të mëdha për figurën e Llesh Vuksanit. Një gjë të tillë e përcolli për mediat gjatë ceremonisë mortore të përcjelljes për në banesën e fundit, edhe Isak Bala, i cili krahas rezultateve pozitive si sportist dhe trajner të kolegut dhe mikut të tij Vuksani, ai do të spikaste edhe për korrektësinë, thjeshtësinë dhe qytetarinë që shfaqte në jetën sportive duke qene një model në këtë drejtim. Të gjitha këto, ai i përcillte edhe në jetën familjare, si një bashkëshort dhe prind model, për të cilën bashkësia kishte respekt të veçantë.

Periudha pas viteve 90-të do ta gjenete Lleshin mes Shkodrës dhe Durrësit. Kishte zgjedhur Durrësin pasi uji ishte ai që e tërhiqte vazhdimisht, aty ku kaloi jo pak vite, por gjithmonë duke mos e harruar qytetin e tij të Shkodrës, aty ku kishte kaluar vitet më të bukura të tij të jetës sportive.

### Vlerësimi “Sportisti i Shekullit” dhe emocionet e Lleshit

Realisht, për gjithë atë karriere të pasur si sportist i “Vllaznisë” dhe i kombëtares së Shqipërisë, më pas edhe si mësues i edukimit fizik, trajner dhe gjyqtar atletike, për Llesh Vuksanin duhej të kishte tituj të panumërt, lokal dhe kombëtarë. Megjithatë, ai që atij iu dha me rastin e përvjetorit të 100-të të Klubit Sportiv “Vllaznia” duke u vlerësuar nga Bashkia Shkodër me çertifikatën si “Sportisti i Shekullit”, vlen jo pak për atë çka ai i ka dhënë sportit shkodran dhe atij shqiptar në përgjithësi.

Në ceremoninë zyrtare të vitit 2019 organizuar në pistën e stadiumit “Loro Boriçi”, momentin kur kryebashkiakja shkodrane, zonja Voltana Ademi i dorëzoi çmimin Llesh Vuksanit, emocionet ishin jo pak të pranishme. “Në këto pista dhe pedana kena nxjerrë shumë djersë. Kam mbi 45 vjet që e kam lënë sportin dhe kur kaloj në bulevard, njerëzit më kujtojnë duke thënë, se ky ka qene hedhësi më i mirë që ka pas Shqipëria. Në një aktivitet ndërkombëtar më falën një shtizë rumunë, dhe e kam ruajë atë shtizë si relike, vetëm gara bëjshe me të, sepse atëherë nuk ka pas as shtiza, as pista, as tartan, një brez i tanë nuk është vlerësu as edhe në minimum”, do të shprehej Lleshi në atë ceremoni zyrtare në praninë edhe të kamerave televizive dhe aparateve fotografike, momente këto që janë edhe kujtimi i fundit me ish kampionin dhe rekordmenin absolut të atletikes shqiptare, disciplina e hudhjes së shtizës, të paharruarin Llesh Vuksani.

Gaspër MARKU



# SIPAS NJË STUDIMI TË KRYER TEK TË SËMURET, QË KALUAN FORMA TË MODERUARA TE COVID-19 (SARS-COV-2) MBROJTJA KA QENE E KUFIZUAR

Profesionistet e shëndetit janë një pjesë e popullit, veçanërisht i ekspozuar te rrezikut për infektim me Sars-Cov-2 (Covid-19)-me potencial reinfeksioni-fakti i marrjes në ngarkim të pacienteve me Covid-19. Në momentin e valës së parë shumë pak të dhëna ishin të njohura mbi përgjigjen imunitare në vijim të një infeksioni dhe ne iu përkushtuam pikërisht çështjes së imunitetit të personelit shëndetësor (profesionisteve) që kanë kaluar forma të moderuara.

Objekti i studimit tone jepet me date 08. 02. 2021 në revistën "Natura Communication" dhe ka për qëllim të përcaktohet nëse në format e moderuara të Covid-19a kanë shfaqje të llojeve të ndryshme të antikorpeve ose të -IgM, IgA, IgG nëse ato kanë një karakter mbrojtës dhe për sa kohe pas infeksionit do të persistojë. -IgG- janë me abondante (75-80%) antikorpeve qarkullues, ato fabrikohen në kohën e kontaktit me antigenin (ndaj baktereve, viruseve trupave të huaj për organizmin). Ato marrin pjesë po ashtu në përgjigjen memorialë të imunitetit, për të cilat përgjigjet mekanizmi i vaksinimit. IgM- janë -IMUNOGLOBULINA të sekretuara në momentin e kontaktit të parë të organizmit me një antigen'. Është klasa e parë e imunoglobullinave të çliruara dhe prezencën e tyre në gjak tregon për infeksion në zhvillim. -IgA marrin pjesë në eliminimin e antigenit që do të jete përball në zorre-shmangia-eliminimi i antigenit, kryesisht do të jete përball në paretin e zorrës. Ato gjinden kryesisht në pështymë, në sekrecionet e mushkërive, të traktit tretës, qumështin e nënës. Roli esencial i IgA, është të pengojnë antigenin në paretin e zorrës, asgjësimin sidomos në sekrecionet e pështymës, në mukusin e mushkërive, në qumështin e gjirit të nënës. Roli kryesor i antigenit IgA, është të pengojnë agjentin patogen, të lidhet me qelizën, dhe veçanërisht me ato të mukozës dhe epidermës (të sipërfaqes së lëkurës).

**Ndjekja e kujdesshme e atyre që kanë pasur një formë të lehtë të Covid-19**

Për t'iu përgjigjur këtyre objektivave ne kemi studiuar, gjatë kohës së shfaqjes dhe persistences se, ato jepen me ane të teknikave të ndryshme se-

rologjike. Po ashtu dhe në kontekstin e tyre mbrojtës. Ne kemi ndjekur 26 profesionist të shëndetit, që kanë paraqitur forma të moderuara të Covid-19. Është një numër i vogël personash, por ne kemi bere eksplorim deri në përgjigjen me anteorpe. Ne kemi vërejt që nga dita e 21 pas fillimit të shenjave klinike, që të gjithë profesionistet e shëndetit ishin serokonvertus, që do të thotë se paraqisnin anteorpe anti- Covid-19. Pra, kishte një përgjigje imunë kundër virusit



SARS-Cov-2.,te tipit igA, IgM dhe IgG që vërtetojnë një përgjigje imunitare kundër-virusit.

Jemi të interesuar për anteorpet e druajtura kundër proteinës S (Spikes)-dhe veçanërisht për receptorët binding domains (RBD) përgjegjës i ndërvepimit e ACE-2 (Angiotenzina convertuse tip-2), receptor qelizor të virusit, që lejojnë të hyj në qelize, për ta infektuar, nga që është shumica kundër kësaj proteine, ku drejtohen për ti neutralizuar. -Ne kemi treguar se IgA-antikorpe pjesëmarrës në mbrojtjen e mukozave, të cilat janë porta e hyrjes së virusit SARS-coV2-, që janë antikorpet neutralizues kryesor, në javët përvijues të infeksionit, ku ato nuk ishin më prezent veçse në 38% të të profesionisteve 3 muaj pas fillimit të shenjave klinike, ku kishim dhe ulje të antitropave neutralizues që prej 2 muajve.

Antikorpet neutralizues janë antitropa të veçante, që lejojnë të prevenohet infeksioni duke bllokuar hyrjen e virusit në qelizat e shënuara, që janë anteorpe të veçante, që lejojnë të

parandalohet infeksioni, duke bllokuar hyrjen e virusit në qelizat e shënuara, ato shoqërohen me shumë korelant mbrojtës, që do të thotë me marker që na lejojnë të përcaktohet ekzistenca e një mbrojtje imunitare ndaj një sëmundje infektive. Një ore pas vaksinimit korelantet mbrojtës anti SARS-CoV-2 (Covid-19), nuk janë akoma të përcaktuar qarte. Në fillim të studimit të këtyre anteorpeve të veçante, në kemi zhvilluar një test, që lejon të matet aftësia neutralizuese antitropave të

pranishëm në serum përball virusit përkatës plotësisht replikativ. Avantazhi i testit residual, që bazohet në fakt mbi "virulence e vërtetë" dhe jo mbi virus artificial ose të rindërtuar. Që do të thotë shumë më afër kalimit fiziologjik. Rezultatet e studimit tone tregojnë se bashkësia e profesionisteve kanë studiuar zhvillimin e anteorpeve neutralizues të SARS-CoV-2 midis 2-4 javëve pas fillimit të shenjave

klinike. Kjo përgjigje imunologjike e hareshme është e lidhur kryesisht me IgA të pranishme në serum-, ne kemi në 15% të profesionisteve të shëndetit zbritje deri në zhdukje të IgA në serum. Po ashtu dhe pse ka një zbritje të IgA, niveli i g G, kundër RBD të S (Spike) proteinës të virusit konsiderohet, po ashtu mbrojtës për një afat të gjatë të jetës nëse mbahet i lartë për 2-3 muaj pas mungesës së shenjave klinike. Kjo nuk do të thotë se të gjithë personat janë të mbrojtur, por mbrojtja bie me kalimin e kohës tek profesionistet e shëndetit që kanë kaluar një formë të moderuar të Covid-19. Pra, këto punime janë në favor të një mbrojtje dhe të masave barrierë dhe të vete profesionisteve të mjekësisë - pasi kanë bere forma fruste, a simptomatike të Covid-19. Në fakt, paraprakisht kemi një popullim veçanërisht të ekspozuar me rrezik infektimi dhe me potence për reinfeksion nga SARS-CoV-2-mesazh ky shumë i rëndësishëm, nga që konstatohet se lihen pas dore, masat barrierat mbrojtës. Profesionistet e shëndetit janë të

rraskapitur nën presion prej mbi 1 viti-blokim, izolim. Pra, është fjala që të forcohen akoma më tepër dhe masat mbrojtës dhe të intensifikohen akoma më tepër dhe të ndëshkohen fajtoret. Aktualisht kemi shumë vaksina që janë hedhur në veprim për të gjithë personat, por fillimisht për të moshuarit dhe personelin mjekësor dhe i kujdesit, -si dhe në azile dhe gjithë profesionistet e shëndetit me tendence për gjithë popullsinë, si dhe ato persona që kanë mbi 3 muaj që kanë kaluar Covid-19. Por, sipas njoftimeve më të fundit, variant i ri Covid-19 (variant jug-afrikan dhe brazilian) - është i pa ndjeshëm ndaj vaksinës 9, në 10 vende përfshira dhe Francën (Universiteti I Edimburgut-Ecosse). -

**A mund të vendoset lidhja midis vaksinimit dhe imunitetit natyral?**

MBROJTJA e një personi kryhet në rastin e një infeksioni gjë që varion nga një person tek tjetri në funksion të gravitetit të tij. Studimet kanë treguar se një numër personash afro 30 %, nuk kanë mbrojtje veçse për disa muaj pas një infeksioni beninj ose pa shenja. Megjithatë nuk janë të rralla rastet e infeksionit pas momentit parë. Përkundrazi personat që kanë kaluar një infeksion të rëndë ose që u zbulohen anteorpe pas 6 muajsh nga kalimi i sëmundjes, kanë mbrojtje. Vaksinimi shkakton një Imunitet me rritjen e anteorpet igG, që ngjason me personat që kanë kaluar forma të rënda të Covid-19, por nuk dihet se këto anteorpe a do vazhdojnë pas 6 muajsh. Dhe vaksinimi do të induktoj shfaqjen e anteorpeve IgA. Shumica e provave klinike nuk kanë arritur të japin të dhëna të sigurta se, ato që kanë kaluar forma të lehta ose pa shenja të covid-19 të jene të mbrojtur. Vaksina moderna ngjason të uli rrezikun për infeksion pa shenja që në dozën e parë, por siguria vjen pasi të kryhet doza e dyte e vaksinimit. Këto rezultate tregojnë për imunitetin humoral me anteorpe dhe nuk llogarisin imunitetin qelizor të gjeneruar pas një infeksioni Sars -cov-2, por nuk dihet se imuniteti qelizor a luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në këtë mbrojtje.

Përgatiti **Dr. Med. Ndue NIKAJ**  
Shkodër

# HISTORIA E LEZHËS NDËR SHEKUJ



nga Profesor Gjon Frani Ivezaj

(Vijon nga numri i kaluar)

## Muret e gjera të Akropolit si mbas Polibit

Lezha mbas pushtimit romak të Ilirisë së Jugut, me 168 para Krishtit, Lezha përmendet si "Municip". Ajo e ruan rëndësinë si qendër ushtarako-administrative dhe si baze detare për Adriatikon verior. Në periudhën romake pati disa rindërtime të rëndësishme të qytetit ilir. Sidomos në Akropol, në hapësirën e qytetit kodrinor, në qytetin e poshtëm dhe në portin lumor. Por trashëgimia e traditave ndërtimore vendase mbijeton dhe është gjithmonë zotëruese. Në zonën kodrinore ku qene vendosur kolonët romake janë gjetur dhe gërmadhat e banesave të tyre prej guri. Rindërtimi romak i qytetit ka qene i pjesshëm. Janë zbuluar dy mbishkrime në latinisht, që bëjnë fjale për këtë rindërtim. Mbishkrimi i pare i gjetur në Portën e Gaviarit, bën fjale për rindërtimin e portës dhe të kullës në të djathtë të Portës. Në mbishkrimin e dyte, 20 m larg të parit, flitet për rindërtimin e murit, nen kujdesin e magjistratit ekzekutiv të Luk Gaviarit dhe të Meges. Një mbishkrim i trete i dëmtuar është gjetur në një bllok guri, në anën veriore, por është i palexueshëm. Kurse mbishkrimin e IV, e ka pare me sytë e tij dhe e ka lexuar Qiriako i Ankones, i cili e ka vizituar Lezhën me 1463. Qiriako thotë se mbishkrimi flet për rindërtimin e mureve rrethuese prej të njëjtëve magjistratë romake. Rezulton se rindërtimi romak i mureve është bere 250 vjet pas fortifikimit ilir. Në periudhën romake pati ndërtime të tipit termal me sistem hidraulik të zhvilluar, si dhe përdorimi i teknikave "Okus reticulatum" apo dhe thjesht "Reticulatum" të shekullit I-II pas Krishtit. Lezha në Antikitetin e vone dhe periudhën bizantine Lezha, në shekujt e pare pas Krishtit nuk u zbeh si qendër qytetare. Administrativisht bënte pjese në provincën e Prevalit, që kishte si qendër Shkodrën. Në periudhën e vonë antike me emrin e Lezhës lidhen dy rruge. Rruga, që lidhte Salonen me Dyrrahun dhe rruga qe nisje nga Lezha në qytetin Nais. Ka një rimëkëmbje të Lezhës në fillimin e shekullit VI. Kështjella e Lezhës është në listën e rindërtimeve të mëdha të Perandorit ilir, Justiniani i Madh dhe përmendet në librin e Prokopit të Qezarese. Rindërtimet e kësaj kohe janë të dukshme dhe qyteti bizantin i Lezhës hyn te qendrat më të mëdha të kohës. Qendra kthehet në një qendër episkopale dhe madje përmendet me emrin i peshkopit Gjon në vitin 592.

Kronikani i njohur si Anonimi i Ravenes e përmend Lezhën në shekullin VII-VIII si qytet bregdetar ilir. Në këtë periudhe ka ndodhur procesi më i rëndësishëm i transformimit të ilireve të lashte në arbrit e hershem. Kjo gjë vërtetohet edhe nga materiali arkeologjik i varrezës arbërore të zbuluar në Qafen e Kështjellës. Ky material arkeologjik është tipik me kulturën materiale arbërore, që lidhet me Durrësin e qendrat e tjera të Shqipërisë. Ka dhe një rifortifikim tjetër të qytetit në fund të shekullit VIII. Me këtë rast, ndërtohen kulla të reja dhe përdoren teknika të reja. Kështu kështjella e Lezhës, përben një simbioze të ndërtimeve ilire, romake dhe bizantine.

Autoret bizantine si: Konstandin Porfyro Gjeneti, Kedreni dhe Ana Komnena flasin për rëndësinë e madhe të qytetit të fortifikuar te Lezhës. Ana Komnena tregon se pikërisht në Lezhe, perandori Aleks Komneni, grumbulloi forcat e tij për t'i çuar në mbrojtjen e qytetit të Durrësit, gjate rrethimit të Durrësit nga ushtria normane e udhëhequr nga Bohemundi me 1107. Në shekujt e mëvonshëm, Lezha përfshihet në Principatën e Arbërisë, pranë Dukatit të Durrësit të krijuar nga Republika Veneciane. Nga aktmarrëveshja e Dhimitrit "Kryezoti i Arbërisë" me Republikën e Raguzës, rreth viteve 1208-1215 ku behet fjale për shkëmbime tregtare dhe për transport mallrash pa taksa, si në rrugët tokësore ashtu dhe në ato detare, vetëkuptohet dhe rëndësia e qytetit të Lezhës, si pike kyçe të raporteve të Arbërisë me Republikën e Raguzës.

Me 1393, qyteti i Lezhës, iu dorëzua Republikës së Venedikut nga Progon Dukagjini. Kështu Lezha përjeton përfshirjen në shtetin venedikas, gjë, që me disa ndërprerje vijoi deri me vdekjen e Gjergj Kastriotit, deri në shekullin XV.

Viti 1478 është viti i pushtimit të Lezhës nga osmanet. Hyjnitë ilire dhe Lezha gjate periudhës së shtetit ilir, deri në pushtimi romak, në Lezhe mbijetojnë kultet dhe hyjnitë ilire. Në kufijtë e Lezhës kemi mbijetesën e të ashtuquajturit Zeus Pathius, një interpretim vendas i krye hyjnisë politeiste të lashte. Nga numismatika e Lezhës kuptojmë ekzistencën e hyjnisë Artemis, të quajtur edhe Diana apo Zana, mbrojtëse e pyjeve dhe kopeve. Ajo që është më e rëndësishme dhe më kryesore është se pikërisht nga një monedhe e Lezhës njihemi me Hyun e mirëfillte të detrave, të njohur me emrin Redon. Këtë zbulim e ka bere arkeologu Kapani Oro, i cili vuri re në një monedhe të Lezhës ekzistencën e një figure burri me kapele karakteristike me strehe të gjate, të quajtur "Kausia". Kjo monedhe ka të shkruar dhe legjendën Redon. Pjesa e prapme e monedhës ka figurën e një anije ilire, një liburne, të përdorur nga labeatet. Deri vonë, portreti i burrit me kapele, është konsideruar si ai i mbretit ilir Gent, dikush tjetër e ka quajtur si një Hermes. Por monedha e Lezhës me këtë portret vazhdon të pritet edhe pas rënies rob të mbretit Gent, me 168 para Krishtit. Në një prerje të vitet 135 p. K mbijet-

ton monedha me portretin e burrit, gjë që përjashton mundësinë, që të jete portreti i mbretit ilir Gent. Si mbas Milan Shullait konkludoi me të drejte se kemi të bëjmë me figurën e Hyut Ilir të Detrave Redon, emri i të cilit mbijeton në toponimin e Kepit të Rodonit, në Veri të Durrësit. Këtë e përforcon edhe figura e anijes ilire ilire, Lempes në shpine të monedhës dhe zbulimi para ca kohe i disa mbishkrimeve në Kepin Leuka, në Jug të Italisë të disa anijeve ilire, njëra nga të cilat mban emrin Redon. Hyu Redon është një krye emër i mitologjisë ilire dhe së bashku me Hyun e Luftërave Medaur, përben një dyshe kryesore të mitologjisë klasike ilire.

Një qytet satelit i Lezhës është Shëngjini, 8 km në Veriperëndim, në bregun e Adriatikut. Jul Cezari, në veprën "Lufta Civile" e përmend emrin e këtij limani si Nymfeum në vitin 48 para Krishtit. Këtu erdhi Flota e Mark Antonit në fushatën e Cezarit kundër Pompeut. Emri Nymfeum lidhet me çetën e nymfave apo të zanave. Nymfeuni, është njohur në epokën romake, si një liman shumë i mbrojtur "Tutisimuss portus". Në mesjete ky lima njihet me emra të tjerë, quhet limani Medua. Në një harte të shekullit XIII të Pjeter Viskontit njihet madje edhe me emrin Medea. Gjate mesjetës përmendet ky liman si "Portus", "Medue", "Porto di Medea". Etimologjia e këtij emri ka mbetur ende pa u sqaruar. Sipas A. Majerit termi Medua, lidhet me emrin antik te qytetit Medeon - Meduni i sotëm, në bregun dalmat. Sipas disa dijetareve të tjerë emri Medea është një jehone e mitit të argonautëve dhe të princshës Medea të Kolkites, gjate shtegtimit në Adriatik nga Ulqini deri në ishullin e Korfuzit. Emri i Medeas është lidhur edhe me emrin e fshatit Mjede. Gjithsesi ky toponim mbart një jehone mitologjike të stërlashte. Kurse Shëngjin është një kalk i emrit të shenjtorit Shën Gjini, ose i shenjtorit Shën Gjon Paguezuesi, që shkurtimisht ka dhënë fjalën Shëngjin. Në hartat e P. Gasparit dhe P. Coronellit, limani quhet San Giovanni di Medua. Kemi kështu një ndërthurje të një toponimi mitologjik pagan të lashte me emrin e një shenjtorit të krishtere. Pra një simbioze mendërisht mitologjike dhe fetare deri në kohën e sotme. Limani i Shëngjinit ka qene në të gjithë kohërat limani detar i Lezhës. Kjo lidhje nuk është zhdukur asnjëherë dhe në ditët tona është përjetuar një rol i ri i Shëngjinit, lidhur edhe me rrugët e lidhjes së Shqipërisë me Kosovën. Limani i Shëngjinit është më i rëndësishmi liman detar në Veri të Durrësit. Vetvetiu merr attribute të veçanta për të ardhmen.

P. Coronelli, kartograf i njohur Venecian i shekullit XVII, në hartën e vet të Drinit dhe Bunës, e cilëson Shëngjinin si liman të afte për anije të mëdha (Porto Medua Capace di Grannavili). Krahas limanit të Shëngjinit, në shekuj është shfrytëzuar edhe një tjetër lima fort i përshtatshëm për strehimin e anijeve 2 km në lindje të tij pikërisht në vendin ku ndodhet sot e veçuar nga deti kënetë e thelle e Knaves. Ky liman natyror përmendet në burimet dokumentare të shekujve XV-

XVII me emrin "Saca", që ruhet edhe sot si trashëgim historik nga lagja Saka në Jug te qytetit Shëngjin. Rëndësia e Limanit të Shëngjinit u shtua mjaft vetëm pas vitit 1880, kur Hoti, Gruda, Ulqini, Tivari, Plavë, Guci e trojet shqiptare ju dorëzua padrejtësisht Malit të Zi, në zbatim të vendimeve të Kongresit të Berlinit.

Plazhi i Shëngjinit përben një nga resurset më të veçanta turistike detare, jo vetëm të Lezhës por edhe të Shqipërisë, sidomos duke pasur parasysh parkun ekologjik të rrethinës.

## Krishterimi në Lezhe.

Në territorin e Lezhës krishterimi është i hershem, që në kohërat apostolike, kjo dëshmohet edhe arkeologjikisht, si dhe nga autoret e lashte. Një rendësi të posaçme për krishterimin e hershem në Lezhe ka dëshmia unikalë e Marin Barletit, në librin e dyte të veprës së tij epokale "Historia e Gjergj Kastriot- Skënderbeut". Barleti tregon për viset rreth Lezhës e Zadrimës përquark lumit Drin: atje shihen shumë gjurmë të lashtësisë, qytete e tempuj fort të përmendur të Perëndisë, të cilët tani të sheshuar dhe të bere gërmadhe po dergjen me shumice përpara syve tanë. Po, në këtë vend, vërehen dhe përmendoret prej mermeri, në të cilat mund të shikohen shumë emra perandorësh romake e të tjera. Në to dhe disa gjurme, nga të cilat kuptohet me një mënyre të mjaftueshme se po këtu, apostulli i pare u ka predikuar njerëzve besimin e Krishtit. Disa gjurme të bazilikave të Antikitetit të Vone flasin për një krishterim të zhvilluar, i cili në mesjete zotëron të tere zonën. Lezha përmendet si qendër peshkopale e rëndësishme gjate periudhës së Perandorit ilir Justiani i Madh. Zbulimi 1 km larg Lezhës, në rrugën që çon në Shëngjin i absides së një kishe të Antikitetit të Vone, i disa kapitelleve me gjethe akanti mund të identifikojnë Katedralen e Peshkopit, njohur me emrin Joan, i cili emërtohet peshkop i Lezhës me letren e Papa Georgit të I, dërguar në vitin 592. Në shekullin XIII, Shën Francesku i Asizit, gjate kthimit të tij nga Siria (para vitit 1221) ndali në Lezhe, ku themeloi të parin kuvend françeskan në Shqipëri.

Dy dekada më vonë ndërtohet kisha e françeskanëve në kodrën përballe qytetit, e cila ka pasur një gur mbishkrimi të skalitur në latinisht: "POC TEMPLUM FRATON MINORUM AEDIFICATUM EST ANNO MCC XV", që përkthet në shqip: "Ky tempull i vëllezërve minore franceskane është ndërtuar me 1240". Nga të dhëna të tjera historike, mësojmë se në këto treva kane lëvizur edhe pjesëtarët e urdhrit fetar të dominikaneve dhe të benediktineve. Sidoqoftë, françeskanet janë urdhri fetar, që ka mbijetuar më gjate në këtë zone. Një gojëdhënë e ruajtur në rajonet e Venedikut, sipas At Vincens Prenushit thotë se, Shën Francesku i Asizit, duke u larguar nga Shqipëria mori një dege pishe të egër, që e mbolli pranë Kishës së Kuvendit

Franceskan të ishullit Deserto afër Venecias. Pema u rrit dhe u quajt Kisha e Shën Franceskut. Deri vonë është ruajtur trupi i thate i kësaj peme, grimcat e së cilës u shpërndaheshin besimtareve për devocion. Kuvendet e vëllezërve franceskane kane qene vatra të rëndësishme intelektuale madje edhe të mësimi të gjuhës shqipe në mesjete e më vonë. Të dhëna të shumta për besimin katolik në Lezhë kemi nga relacionet drejtuar Papatit në shekullin XVII, ku rendësi të veçante merr familja e Bardhejve. Nga kjo familje kane dale peshkopë e dijetarë të famshëm shqiptarë si Tosol Bardhi (1490-1582), Nikolle Bardhi (1551-1617), Gjergj Bardhi i shekullit XVII dhe sidomos Frang Bardhi i nipi i Gjergjit, një nga figurat më madhore të kulturës kombëtare shqiptare. Si kishtar i njohur, përmendet edhe Mihal Bardhi, Nino Bardhi dhe Pal Bardhi, po në shekullin XVII. Nga familja e Bardhajve, shquhen edhe prijëse ushtarake si Preng dhe Pal Bardhi, që shërbyen në flamurin e Venedikut. Lidhur me rëndësinë e madhe të fesë katolike si ndërlidhëse e shqiptareve me Italinë dhe Evropën Perëndimore, theksojmë se Lezha behet qendra e dy kuvendeve të mëdha historike, e Kuvendit të Lezhës me 1444 dhe e Kuvendit të Arbrit me 1703. Nga gërmimet arkeologjike, por dhe nga të dhënat e relacioneve të M. Bicit, B. Orsinit e të tjerë, mund të konstruohet koleksionin e kishave të zonës së Lezhës. M. Bici flet për një kishë të madhe që mbante 2000 vete, jashtë qytetit në breg të lumit të Drinit, ku shërbenin fretërit françeskane, të cilët kishin edhe një kuvend në qytet. B. Orsini përmend kishën e Shëngjergjit në qytet, kishën e Shën Marisë së Bores, kishën e Shën Sebastianit, kishën e Shën Nuciates, kuvendin e vogël të fretërve me një kapele përbrenda, kishën e Shën Margaritës, kishën e Shën Marisë, kishën e Manastirit të Shën Antonit e të tjera. Gjithashtu dokumentohet edhe kisha e Shën Ethumesie në Kashnjet. Teodor Ipen flet për manastirin e vogël të Françeskanëve të rindërtuar në shekullin XX, ku ka qene dhe një gur i murosur në portal me mbishkrim në gjuhen latine, pjese e një arkitrau të portës së një faltoreje më të vjetër. Me 2 mars 1444 u bë kuvendi në qytetin e Lezhës, që ishte në zotërimin e Venedikut, u organizua kuvendi i princërve shqiptarë, ku morën pjese Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë Dukagjini, Pal Dukagjini, Teodor Korona Muzaka, Lek Zaharia, Lek Dushmani, Gjergj Stres Balsha, Pjetër Spani, Stefan Cenojevici e të tjerë. Ky kuvend u bë në Katedralen e Shën Nikolles dhe jo rastësisht në Lezhën venedikase. Kuvendi krijoi "Lidhjen Shqiptare" me Gjergj Kastriotin, si kryetar të saj me titullin "Kapiteni

Përgjithshëm" (Capitaneus Generalis). Kuvendi i Lezhës është nga ngjarjet më të mëdha unifikuese të kombit shqiptar në histori. Kuvendi i Arbrit, Merqi 1703, në janar të vitit 1703, në fshatin Merqi të Lezhës u mbajt Kuvendi i Arbenit, i njohur ndryshe si Koncili i Arbenit. Ky kuvend u bë me nismën e Papës me origjinë shqiptarë, Klementi i XI, si dhe të autoritetit të arkiveshkvit të Tivarit, Disk Smajevic (1701-1713). Kuvendi i Arbenit mori vendime të rëndësishme, jo vetëm të karakterit organizativ fetar, por edhe politik dhe atdhetar. Sipas Dr. Engjell Sedaj, Kuvendi i Arbenit është kujtesë e dokumentuar dhe e pashlyeshme e historisë së popullit shqiptar në dimensionet më të gjera të jetës së tij. Ky Kuvend është më i

Katedralen e Shën Nikolles. Sipas tregimit të Marin Barletit, turqit i morën kockat e Skënderbeut, i mbështollën me flori dhe argjend për t'i përdorur si hajmali të pathyeshmërisë në betejë. Me 1506 pushtohet nga turqit edhe ishulli i Lezhës. Kështu vendoset pushtimi otoman kudo. Nga një mbishkrim i gdhendur në një pllake mermeri, mësojmë se në vitin 1521 një pjese e kështjellës së Lezhës, është ndërtuar nga Sulejmani, biri i Selimit, i cili që gjithashtu biri i Bajazit Konit. Procesi i rindërtimit që bëri në mbikëqyrjen e Muhamet Dervish Orguzit. Pushtimi otoman bëri ndryshime në strukturën urbanistike dhe arkitektonike të Lezhës. Gjate shekujve të këtij pushtimi nuk kane reshtur kryengritjet dhe revoltat e

katedrale, në shekullin XVII, që shndërruar në xhami. Themelet e saj janë të shekullit XIV, katedralja është e tipit bazilikë me gjatësi 17 m dhe gjerësi 8 m. Ruhet në muret e saj një afresk i Shën Nikollës. Sot rrënojat e Katedrales së Shën Nikolles janë shtruar në memorialin e Gjergj Kastriot-Skënderbeut, padyshim një nga monumentet më të mëdha të historisë kombëtare të shqiptarëve në të gjitha kohërat. Sipas studiuesit A. Mutjakoviç i Mihajl Obranoviç, mbështetur në disa dokumente shkrimore të arkivave të Raguzës, del se Andrea Aleks Durrsaku, skulptor dhe arkitekt gjenial i të ashtuquajturës Rilindje Dalmatine është me origjinë e të pareve të tij nga Lezha. Në shumë dokumente të artistit ai e quan veten



rëndësishmi mbas Kuvendit të Gjergj Kastriotit-skenderbejan të Lezhës me 2 mars 1444. Në dokumentet historike turko-venerianë të shekullit XV përmendet shpesh Ishulli i Lezhës. Një informacion i gjere për të është në "Ditarët" e M. Sanutos. Lezha u pushtua nga turqit me 1478, qyteti u dogj, u shkatërrua, banoret e tij u zhvendosen në një zone, jo shume larg në ishullin e formuar në grykëderdhjen e lumit të Drinit. Ishull i Lezhës u bë një vendbanim kryesor për lezhjanet. Në 5 mars 1501, në Ishullin e Lezhës, zbarkoi nga Italia me trupa ushtarake nipi i Gjergj Kastriot-Skënderbeut, i njohur si Skënderbeu ri. Ai kryesoi kryengritjen mbareshqiptarë, por që pësoi shumë shpejt disfate. Në vitet 1478-1501, për 23 vjet, Ishulli i Lezhës, që i vetmi vend në bregdetin e Shqipërisë së Veriut, që qëndroi i lire, i pavarur dhe i veteadministrueshem. Pushtimi otoman, me 1478 turqit pushtuan Lezhën, hapen varrin e Gjergj Kastriot-Skënderbeut, vdekur me 17 janar 1468, dhe e varrosen në

shqiptarëve kundër pushtuesve. Në fillim të shekullit XVIII Lezha ishte në sanxhakun e Shkodrës dhe ishte qendra e nahijes, që quhej Nahi e Lezhës. Me 1768, Mehmet Pasha sulmoi lezhjanet me një ushtri 2500 vete po nuk i theu dot. Lezha, me 1770, u mor nga ushtria e Mehmet Pashe Bushatllit. Me 1793, lezhjanet përkrahen Kara Mahmut Bushatiliun, që që rrethuar në Kështjellën e Shkodrës nga turqit. Me 28 nëntor 1793 lezhjanet sulmuan ushtrinë turke, që kish rrethuar Shkodrën, duke i shpartalluar ata. Lezha e përjetoi fuqishëm epokën e Pavarësisë së Shqipërisë me 28 nëntor 1912 si dhe të gjitha epokat e mëparshme deri në ditët tona. Kultura dhe Etnografia Katedralja e Shën Nikolles, artikulli kryesorë: Katedralja e Shën Nipollësh Katedralja e Shën Nikollës ka një rëndësi të posaçme historike për shqiptarët, jo vetëm për Kuvendin e Lezhës, por edhe si vendvarrim i Gjergj Kastriot-Skënderbeut. Kjo

"Andrea De Alesio", që lidhet me emrin e Lezhës në Mesjetë. Ruhet kopja e testamentit të bërë nga dora e Andreas, i cili e quan veten "Duca Sinovicch", që Interpretohet si formë e konvertuar e emrit të familjes së njohur shqiptarë, Familja e Dukagjinëve, që kanë qenë edhe zotërinj të Lezhës. Në këtë klimë të begatë, që herët u shquan individë me emër në kulturën tonë kombëtare si Lekë Dukagjini, Kanuni me emrin e tij (Shkodër 1933), që u mblodh në kapërcyell të shekujve XIX-XX nga At Shtjefën Gjeçovi, është monumenti më i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar. Ndër shprehjet e tij, që kanë mbërritur si fjalë të urta deri në ditët e sotme, mund të përmendim: "Je i lirë me mbajte burrninë tënde, je i lirë me u zburru". Frang Bardhi (1606-1643) nga Kallmeti, ipeshkëv i Sapës (Zadrimës), është autori i më të parit Fjalor latinisht-shqip (Romë, 1635) me rreth 5 mijë fjalë dhe i Apologjisë për Gjergj Kastriotin (Venecia, 1936), shkruar në latinisht.

# PRENDA SEJËDIA NJË PENË E SPIKATUR E BUJTINËS LETRARE LEZHIANE



Është poete eseiste dhe studiuese e njohur në bujtinën letrare të Lezhës

Ka lindur në fshatin plote gjelbërim dhe emërmirë Bugjon (PUKË). Rrënjët e saj janë të thella sa vetë jeta, ku atje flet fisnikëria e gjuhës e zonës së krahinës madhështor të Thaçit. Në moshën shumë të njomë, familja e saj u vendos në Tropojën

kreshnike, ku veçon mirësinë që ka bashkësia e asaj ane, si malësorë të Malësisë së Gjakovës. Ajo u pajis me plot virtyte humane e njerëzore, që e përcjellin gjatë gjithë rritës e jetës së saj. Atje mbaroi mësimet fillore e të mesme. U diplomua në Universitetin "Luigi Gurakuqi" të Shkodrës. Kreu Fakultetin e Mësuesisë.

Që nga viti 1993 punon e vepron në Lezhën e Besëlidhjes, në këtë qytet model me tradita kulturore, patriotike e atdhetare. Marrëdhëniet e shkëlqyera me familjarë, miq e të afërm kanë qenë çelësi i suksesit dhe gjithë botëkuptimi i saj, që e përcjell si personalitet.

Puka -Tropoja – Lezha, është ky trekëndëshi, që i jep botëkuptim punës, jetës e veprimtarive, por dhe krijimtariisë së saj poetike. Ajo, tanimë përveç kontributit arsimor të shpërndarë ndër breza, në vitet e demokracisë i shërbeu vendit e popullit të saj brenda veprimtarive politike, si femër e dëshmuar për suksese në këto anë.

Dhe, tanimë duke e dëshmuar veten e saj edhe në art, në veçanti në lëmin e poezisë, si dhe të përgatitjes së monografisë historike, që do të dalin së shpejti.

Librat e publikuar:

1. "Memoaret e shpirtit",
2. "Profecia e mëkatit",
3. "Kur të jesh mërztur".
4. "Këmbanat bien",
5. "Puhizat e mëngjesit",
6. "Frymëzimi je ti",
7. "Imazhet e stinës",
8. "Qiejt e ëndrrave",
9. "Qiejt e shpirtit",
10. "Dhimbje largësishë",
11. "Eklipsi i stinëve",

Antologji: "NA BASHKOI POEZIA -7", Dibra ime, poezi, 2020.

Revista: "METAFORA- 20", Prizren, 2020.

Revista: "METAFORA- 21", Prizren, 2021.

Në këtë numër po botojmë një buqetë poezi të përzgjedhura nga tematika e gjere dhe larmishme e krijimtariisë së sajë poetike.

Urojmë që penda e saj, ashtu siç ka filluar vrullshëm, të rrjedhë në vazhdimësi mjalta e fjalës, me të cilat do të shijojnë e frymëzohen brezat e së ardhmes!

## NË LOG TË ACARIT

Keq janë tharbëtuat motet ballkanike

Buka e atdheut s'po

S'po vie se s'po vie

Mot i lig mbi re e ne

Lisat janë dëshmi të kohës

Se vaditur qenë me gjak zemre

Nuk erdhi se nuk erdhi asnjë rrugë

Vajti vonë e prapa kohët na përgojnë

Se hienat s'dinë as të flenë

Në gjoksin e dallgëve kanë zënë vend

Dhimbjet e shpirtit të atdheut  
Afërsinë ta ndjej thellë në dhimbje  
Brenda brigjeve të zbrazëta

Fantazma akujsh ndër ditët me diell  
Dritës i zhveshën trugun e mishtë  
Eh kësaj vjeshte me gjethe e ngjyra  
Acari mbeti në log të acarit  
Mes përmes udhës vet  
Pikë për pikë pa zë gëlltiti ajrin

Me mjeshttrinë e vrasjes muzgut  
Qosh në qosh ballkanit vogël  
Deri te currilat e fikur në gurë  
Zëri ju dëgjua hiri syve ra  
Degdisi gjetet mbi degët e thyera  
Gjatë udhëkryqeve mbeti e nesermja  
Zot na ruaj nga pamundësia

## NË SHALËN LEGJENDARE

Ajo ditë e bukur vjeshte  
Buzë lumit të kthjellët e gjarpërues  
Ky imazh dua të zgjasë pafund

Dita që e bukur dhe e grohtë  
Gjithë qënjen ma dehu natyra  
E magjishme gjithëçka që e rrethon

Lumi gjarpërues me kthjellësi kristali  
Rrethua e mrekulluar nga mijëra zymbyla  
Këta banorë të veçantë të bjeshkëve shqiptare

Dielli rrezaton mbi to seç thyen rrezet  
Tek lahet me ujën e zanave  
Në atë breg lumi të Shalës legjendare

Kallinjte e dëshirave mes alpeve shqiptare lëkundën  
Veçse kupa e qiellit i dëgjon zënë  
Kështu ëndërroj e lutem gjithnjë

Mbi zjarrin e dëshirave bien ujvarat e shpresës  
Bashkë me legjendat shekullore  
Ogurmirë mbi Shalën e dukagjinit  
Bujaria besa e bukuria fisnike sa jeta

Larmi stolisur plot ngjyra e legjenda  
Ujvarë rrjedh mbi dëshirat e shpirtit  
Tek ajo kështjellë drite që ndriçon nën qiell  
Pishtarë i pashuar për Shalën Legjendare

## PRIZRENIT HISTORIK

Pas teje po lëvizin dekadat shekujt po numërohen  
Luanët vërshuan nën dritën e hënës  
Grusht u mblodhën si ëndërra muzgu shpërthyen  
Abdyli, Sulejmani, Ymeri e Haxhiu e qindëra u dyndën  
Poshtë syrit të kështjellesë së lashtë  
Diell e hënë dëshmitarë u bënë  
E lumbardhi nën urën 500-vjeçare  
i dëgjonte përsiatjet  
Atë ditë të nxehtë qershorit  
Në Prizrenin historik gjithë stinët i mblodhi

Mbi vete mbajtën pezmin e fjalës  
Gozhdët e kryqëzimit Shën Naumit ia shkëlqën  
Veç sa për tu mbajtur frymën gjallë  
Skaj më skaj u mblodhën burrat e shqipërisë  
Ashtu si pika e ujit i flet burimit

Si një zë i vetëm i folët perëndimit

Nga zemra e gurit fjala rrodhi  
Të mbrohet bashkimi kombëtarë e territori  
10 qershorit 1878 u bë kurorë bashkimi

Ti Prizreni i bukur qendër qytetërimi  
Historia legjendare u ndje dhe prapa diellit  
E pashlyeshme do të mbetet  
Në mendjet e njerëzimit

## JU MIQËSIA IME

Për ju miqësia ime  
Në këtë ditë të bukur vjeshte  
Fjalët do i mbledh e ti hedh në fletë

Ëmbëlsia le të mblidhet në fjalorin e ditëve  
Si klithmë le të dëgjohej deri prapa diellit  
Fryma e besimit në emër të engjejeve të bekojë

Le ti mbarë shtojmë ditët e bardha  
Gjaku i miqësisë të depërtojë ndër damarë  
Sepse dhe pika e ujit i thërret burimit

Honit të ndarjes ti mbyllim dritare e derë  
Në shpirtëra tanë mbifitë vjeshta me ngjyra  
Bujarja e fisme deri në kupën e qiellit

Edhe kjo dekadë po e mbyll historinë  
Nëse sekretit i ecjes përpara qëndron tek nisja  
Arritja le të jemi ne në dekadën e re

Jetës le ti japim më shumë jetë  
Nëpër fushat e bleruara të mendimeve  
Mbi dallgët e blerta të ujitur nga uji jeshil  
Për miqësinë e vërtetë

## TI BUGJON NA BËN KRENARË

Hijet e mbrëmjes u veshën me qyrkun e muzgut  
Në atë majën mjegullore të kodrës  
Krahët e veshur të aheve blerim vere

Hija e mjegullës varur deri mbi lumin Drin  
Plot ngjyra ëndërrash ngazëllyese të verës  
Me zërat e pafundëm të njerëzisë të dyndur atje si vizitorë

Eh asaj ane frymëmarrjen ia shtojnë  
Çdo gjë të ngjan aq madhështore  
Dhe kënaqësia është si zjarr o Perendi

Peizashe piktoreske e tëra magji  
Vizatuar nga hëna që sheh përmbi  
Ndër brigje deri në majë e tëra madhështi  
Shpirti i mbushur plot nostalgji

Në ngjitesh atje në atë majën e lartë  
Sikur prek ata yje të zjarrtë  
E natës i vjedh e gjithë magjitë  
Je aq pranë sa flet me perenditë  
Mbi serxh e Bugjon apo guri Jeremsinës

Me burra e burrëshka që pate nga mot  
Ata djem e burra të fisëm që krenohem sot  
Dhurove e dhuron vlera për këtë botë  
Qoftë i nderuar sa të t'jetojë kjo tokë

Paraqiti Prele Milani

## REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,  
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan  
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon  
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
KUJTIM FUNIÇI

